

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI
Zv/kryeredaktor: Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7315 shtunë 7 Tetor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)


Opinion **Ditës**
“Do që të bësh të famshëm një laps...? Po, po një laps! Nxirre përpara kamerës televizive dhe thuaj që e ka mbajtur në dorë mbreti! U bë! Nëse do të bësh të...”
Vijon në faqen 21

Nga ANDON ANDONI
Mësuesi, jo vetëm i portaleve dhe skupeve televizive



Opinion **Ditës**
“Dua të falënderoj ambasadorin amerikan që më mbështeti mua...Unë kam thënë që ne duhet të hyjmë në një fazë të re”... Kjo deklaratë e kryeministrit Rama...
Vijon në faqen 14

Nga KIÇO BLUSHI
Si mund të kuptohet “mbështetja” e Lu-së për Ramën



INTERVISTE/ Flet mbesa e Besnik Sulkut, Sara Alliu

“Biseda e fundit që bëra me dajën, ai nuk mendonte më as për familjen”

Seanca në Gjykatën e Krimeve të Rënda për vrasjen të “Treni”. Sara: Besniku ishte betuar që do hakmerrej për të vëllain

Nga INA ALLKANJARI

Daja im, Besnik Sulku ishte betuar se do të marrte hak, sepse ka qenë shumë i lidhur me vëllain e tij, Durimin dhe e ka pasur pjesë të shpirtit”. Kështu deklaroi dje në një intervistë për “Gazeta Shqiptare”, mbesa e Besnik Sulkut, Sara Alliu. Ajo pohon...

Në faqen 8

RRETH 35 MIJE ARSIMITARE DO TE PERFITOJNE SHITESH RROGE, JA SA SHKON

PAGAT E MESUESVE DO RRITEN 40 PER QIND

Ministrja e Arsimit: Shtesa do të jetë graduale në katër vitet e ardhshme. Trajnim për 20 mijë arsimtarë që kanë performancë të ulët



(Në foto) Ministrja e Arsimit, Lindita Nikolla, gjatë takimit me mësuesit

BASHKËQEVERISJA

Rama: Fshesë të hekurit parazitëve, ‘Stop korrupsioni!’ nuk funksionoi

Në faqen 3

DEKLARATAT

Debati me Greqinë, Kozias: Paradoksi i shqiptarëve. Si u përgjigj Bushati

Në faqen 2

INTERVISTA

Historia e djalit me 4 gra në Berat, flet nusja: Si më përzuri nga shtëpia

Në faqen 7

LISTA E PËRDITËSUAR

Prongrët në Shkodër, kush është kompensuar e statusi i pronës

Në faqen 10

INTERVISTA NE “NEWS 24”



Ambasadori i Kubës: Do të avancojmë marrëdhëniet mes dy vendeve

Në faqen 11



Zajmina në muajin e 6 të shtatzënisë, incidenti ‘hot’ i Luanës

Ja kush është vjehrra e Floriana Garos

Marrëdhënia e prezantueses me Lumturien, historia e saj në politikë

Të shumtë ishin ata që u habitën kur dëgjuan për lidhjen e re të Floriana Garos dhe Enis Daci dhe u bënë kuriozë për të njohur edhe më shumë djaloshin simpatik, që i kishte rrëmbyer zemrën bukuroshes shqiptare. Prezantuesja këtë sezon nuk u shfaq më në



ekran, as nuk jeton më në Shqipëri. Ajo ka nisur një jetë të re në krah të fejuarit të saj, avokatit Enis Daci, i cili ka një karrierë të suksesshme në Zvicër. Ata kanë nisur atje bashkëjetesën, ndërsa Floriana në intervistën e fundit për...

Suplement

QEVERIA REAGIMET

Bushati: Ligji i luftës, si t'i përgjigjem vajzës që mban emrin e një perëndeshe greke?!

Valentina Madani

Shqipëria dhe Greqia vazhdojnë të debatojnë për çështjet e mbetura pezull mes dy vendeve fqinje. Çështja e teksteve të historisë dhe gjeografisë në shkollat shqipe, është një temë e hapur në Greqi, ku vërehet se në librat e historisë, Konica, Kosturi, Follorina, Preveza dhe Arta prezantohen si toka shqiptare! Televizioni "Star" përgatiti një kronikë, ku pyeti për këtë temë, ministrin e Jashtëm grek gjatë takimit ministror në Selanik. Në përgjigjen e tij, Kotzias tha me tone humor: "Ka një paradoks. Zgjohe mi në mëngjes me muzikë greke për të shkuar me energji dhe vitalitet në punë dhe pastaj shajmë grekët. Pastaj pimë një kafe, hamë një suflage alla greke, dhe përsëri shajmë. Ky është një para-

Kotzias: Paradoks, shqiptarët dëgjojnë këngët tona, e na shajjnë!

Amanatidis: Shqipëria e bllokuar në perceptimet anakronike

dos". Debatit është zhvendosur edhe në parlament, ku deputeti i ANEL, Dimitris Kammenos tha se "Po flitet për çamët dhe Çamërinë" dhe se e sheh këtë si një "levë të Turqisë". Kurse zëvendës ministri i Jashtëm Ioanis Amanatidis shprehet se "Shëtit shqiptar është i bllokuar në perceptimet anakronike, nacionaliste dhe irredentiste". Në takimin ministror në Selanik, ku u diskutuan çështjet e energjisë dhe sig-

urisë, morën pjesë veç ministri grek dhe atij shqiptar, edhe ministrat nga Shkupi dhe Bullgaria.

REAGIMI

Ministri për Europën dhe Punët e Jashtëm, Ditmir Bushati në një intervistë për televizionin grek "ERT" shprehet se dialogu me fqinjët do të konkludojë në zgjidhjen e të gjithë çështjeve të mbartura. Kreu i diplomacisë shqiptare, tekso ka folur pas përfundimit të

takimit të dytë ndërministror mes Greqisë, Shqipërisë, Bullgarisë dhe Maqedonisë në Selanik, me pjesëmarrjen e ministrave të Jashtëm, të Brendshëm dhe të Energjisë, është shprehur se tashmë janë identifikuar problemet dhe po punohet nga të dyja palët për zgjidhje. Çështja e ligjit të "luftës së Greqisë me Shqipërinë" që nga Lufta e Dytë Botërore, kufiri detar, varrezat për të rënë në Luftën e Dytë

Botërore janë pjesë e diskutimit për të marrë rrugën e zgjidhjes. Bushati nuk ka munguar që të nënvizojë faktin se dhe vajza e tij ka emrin e një perëndeshe greke dhe si kryediplomat e ka të vështirë t'ia shpjegojë çdo herë se përse ka ligj luftë të mbartur që nga Lufta e Dytë Botërore mes Greqisë dhe Shqipërisë. "Kur ime bijë që ka një emër grek, emër të një perëndeshe greke, Hera, lexon libra që



Kryeministri Edi Rama gjatë prezantimit të djeshëm të platformës online

Greqia ka një ligj lufte me Shqipërinë, unë e kam të vështirë t'i përgjigjem në radhë të parë si ministër i Jashtëm, sepse si baba unë mund ta kem një përgjigje gjithnjë, se pse është kjo situatë në shekullin e XXI", deklaroi z.Bushati.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Institucioni i Presidencës

NJOFTIM PËR SHPREHJEN E INTERESIT PËR POZICIONET E KESHILLTAREVE LIGJORE DHE EKONOMIKE PRANE KOMISIONIT PAVARUR TE KUALIFIKIMIT (KPK)

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", dhe vendimit të Kuvendit nr.93/2017, shpall vendet vakante për pozicionet e **keshilltareve ligjore dhe ekonomike** per institucionin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, konkretisht për **keshilltare ligjore (12) dhe keshilltare ekonomike (4)**.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 23-27.10.2017 në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së aplikantëve, se bashku me dokumentet perkatese, pranë institucionit të KPK-se në adresën: **Rruga e Kavajes, Ish-Lidhja e Shkrimtareve, Tiranë, zyra e protokollit, nga e Hëna-Premte, ora: 09:00-16:00.**
- Kërkesës me shkrim dërguar me postë zyrtare në adresën: **Rruga e Kavajes, Ish-Lidhja e Shkrimtareve, Tiranë.** Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda dates 27/10/ 2017, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatin e lëshuar nga

institucioni përkatës postar. KPK konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

- Kërkesë për aplikim përmes postës elektronike në adresën: komisionipavarurikualifikimit@gmail.com; tek institucioni i KPK-se, i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

- a) **jetëshkrim profesional**, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
- b) **kopje të dokumenteve të noterizuara ose të njësuara nga organi përkatës, që vërtetojnë kushtet e parashikuara në nenin 22, pika 3 (per keshilltare ligjore) dhe pika 4 (per keshilltare ekonomik) te ligjit 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.**

REDAKSIA: Redaktor i Suplementeve dhe Sociales: Rezarta Delisula, Redaktor i Rrethëve: Trëndafilë VISHA, Redaktor i Kulturës: Fatmira Nikolli, Art Designer: Nevila SAMARXHI.

ADMINISTRATA: Përgjegjëse e Financës: Alma Smokthina 0682074397, Shpërndarja: Elvis Llaka Cel 0682074416, Marketingu: Cel:0682074415 -email: marketing@gazetashqiptare.com, ADRESA: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotrotorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 Marketingu: Tel:(04) 2359-104/359-123, Tiranë, Internet: <http://www.gsh.al>, Email: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, SHTYPTOR në "Klasik"Shpk



Kryeministri prezantoi platformën e bashkëqeverisjes me qytetarët

Rama: Fshesë të hekurt parazitëve "Stop korrupsionit", nuk funksionoi

Qytetarët mund të thërrasin në interpelancë kreun e qeverisë

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama prezantoi dje platformën online për një bashkëqeverisje me qytetarët. Tashmë çdo qytetar që ka një ankesë, një nisim të re për të propozuar, apo që kërkon interpelancë me kryeministrin apo ministrat mjafton të shkruajë në faqen online "shqiperia-qedua.al". Kjo ishte garancia që dha dje, kreu i qeverisë se gjithçka do të dëgjohet dhe do të zgjidhet nga qeveria. Në një takim me mbështetësit e tij, Rama vlerësoi këtë një përpjekje serioze të PS-së për të ndërtuar një koalicion real me njerëzit e zakonshëm, "duke i bërë ata pjesë të një procesi vendimmarrës në kuptimin e vërtetë të fjalës". "Do ndëshkojmë së bashku një shfaqje korruptive, do të ndëshkojmë së bashku një sjellje abuzive dhe një zrytar në rast se vërtetohet se denoncimi është i saktë", theksoi dje, gjatë prezantimit Rama. Saimir Tahiri do të jetë koordinatori kombëtar për bashkëqeverisjen me njerëzit për mandatin e dytë të qeverisjes. "Kemi prezantuar një koordinator kombëtar për bashkëqeverisjen, që është Tahiri. Nuk e pashë sot, por me siguri do jetë dikë. Do të vendosë në dispozicion eksperiencën dhe bashkë me koordinatorët në qarqe do të bëjmë këtë gjë, me mbështetjen e të gjithëve ne. Do të angazhohemi ne, qeveria, deputetët dhe të gjithë. Kjo në fazën e parë do të bëhet me fjalë, por shumë shpejt me vepra me prova", u shpreh Rama, ndërsa ende nuk e kishte vënë re në sallë, Tahirin. "Duke shkuar dhe thënë "ja ky rast", "ja edhe ky rast", përfshihim edhe ju. Ky mekanizëm mund të bëhet një fshesë e hekurt për të pas-truar grabitqarët dhe parazitët nga administrata shumë më shpejt se çdo tjetër. Ka dy rrugë, njëra koalicioni ku ishim, kjo është një rrugë e re, do të funksionojë ose jo, nuk e them dot sot,



Kryeministri Edi Rama

DENONCIMET

Në platformën e re të shpallur nga qeveria, qytetarët mund të denoncojnë edhe familjarët e tyre. "Do ketë marrëveshje me kryebashkiakët që do të përfshihen në këtë proces. Dhe njerëzit mund të ankohen qoftë për politikën, ligjet, apo pa diskutim sjellje korruptive apo abuzive. Mund të ankohen për diçka që ndodh në rrethin e tyre shoqëror dhe familjar", tha Rama



PS mbledh sot Asambleshë Kombëtare, kush janë emrat e zv.ministrave të rinj

Partia Socialiste mbledh sot, Asambleshë Kombëtare, ku kryeministri Rama do të prezantojë edhe emrat e rinj të zv.ministrave, por edhe projektet e 100 ditëve të para të qeverisjes. Burimet bënë të ditur dje, se zv/ministrit e Jashtme pritet të propozohet Artemis Dralo, përfaqësuese e minoritetit grek, zv/ministrit e Brendshme Rovena Voda, zv/ministra të Financave dhe Ekonomisë, Luneta Sufati (ish-drejtoreshë e Lojërave të Fatit) dhe Etien Xhafaj (ish-shef kabineti i Arben Ahmetaj, si ministër i Ekonomisë) dhe zv/ministrit e Bujqësisë, Besa Spaho. Mësohet, gjithashtu, se Ministria e Brendshme do ketë katër zv/ministra nga tre që kishte katër vite e kaluara nën drejtimin e Saimir Tahirit. Shtimi i një portofoli zv/ministrit është bërë për shkak se kësaj ministrie i është shtuar si përgjegjësi edhe pushteti vendor pas shkrijës së ministrisë me të njëjtin emër. Në këtë dikaster e konfirmuar është vetëm Voda, e cila më parë ka mbajtur detyrën e shefit të kabinetit të ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj. Në rëndin e ditës së mbledhjes së sotme, e cila do të nisë në ora 10:00, në Hotel Tirana Internacional është parashikuar prezantimi i objektivave të 100 ditëve të para të qeverisjes. Më pas do të jetë prezantimi i konceptit dhe planit për bashkëqeverisjen që do të bëhet nga Saimir Tahiri. Pika e katërt e mbledhjes është organizimi i zgjedhjeve brenda partisë, ku do të referojë Bashkim Fino dhe në fund do të jetë edhe fjala e kryetarit të PS-së, njëherësh Kryeministrit Edi Rama.

ZV.MINISTRAT E RINJ

- zv/ministrit e Jashtme Artemis Dralo
- zv/ministrit e Brendshme Rovena Voda
- zv/ministra të Financave dhe Ekonomisë, Luneta Sufati
- Etien Xhafaj
- zv/ministrit e Bujqësisë, Besa Spaho.

GRUPET E PUNËS

"S"ka më letra nga populli. Një grup i tërë njerëzish do të ndjekin në kohë reale çdo kërkesë apo ankesë dhe do të bëjnë verifikimin të të gjithave ankesave, që lidhen me persona apo zyra. Ditën e hënë do të jenë në gatishmëri 25 persona. Këta do të ndahen në grupe, një grup qendror në Kryeministri dhe grupet e tjera në çdo ministri dhe sikur do e shikoni sipas të gjitha kategorive, që ka platforma opinionet ndahen në bazë të kategorive", sqaroi Rama.

Paloka: Po nuk e përmbysem Ramën, Enveri do na duket yll demokracie

Nënkryetari i parlamentit dhe deputeti i PD-së, Edi Paloka reagoi dje, për platformën e prezantuar nga Rama. Në një postim në "Facebook", Paloka thotë se nga sot vendi nuk ka më nevojë për opozitë. Po nuk e përmbysem, tha Paloka, Enveri do na duket si yll demokracie. "Nga sot nuk ka nevojë më për opozitë, madje nuk ka nevojë fare që shqiptarët të votojnë. Nga sot, siç e shpalli lideri global, do të bashkëqeverisim të gjithë. Vetëm lideri do jetë atje lart për të kontrolluar që gjithçka të shkojë mirë. Po nuk e përmbysem, Enveri do na duket si yll demokracie", tha Paloka.



por është një rrugë e një qëllim shumë të mirë dhe të gjitha mundësitë që të na nxjerrim aty ku duam, jash të zullimit dhe batakut, që është trashuar në gjithë këto vite", theksoi Kryeministri. "Jo të gjitha zotimet mund të bëhen realitet, por ai që do të bëhet është që

shqiptarët të mos shikohen më nga xhepi për të marrë një zotim", tha ai më tej. Në fjalën e tij, Rama e pranoi se portali i denoncimit "Stop korrupsionit" dështoi, por u shpreh optimist se këtë herë nisima e re do të funksionojë. "Ka pasur portale dhe ka faqe në internet, nisima

qëllim mira, p. sh. Ne kemi nisur më parë "Stop korrupsionit" dhe për hir të së vërtetës nuk ka funksionuar sikur dëshironim. Nuk e di pse, por ne do të angazhohemi në të gjithë territorin për ta promovuar territorin. Kjo është një platformë për të gjithë qytetarët, që duan të na vënë në provë për seriozitetin për ta bërë realitet bashkëqeverisjen. Nuk kushton, nuk duhet të paguash asnjë rryshet. Nuk duhet asnjë mik, që ajo që t'i shkruan të lexohet. Zgjedhja është: ose prano të posh-tërosh nga një nëpunës i rëndomtë që kërkon rryshet ose do të thuash "Stop" nuk jap rryshet, por do të bëj të mundur që edhe ky të mos jetë këtu", u shpreh Kryeministri. Gjatë prezantimit të platformës për bashkëqeverisjen, Rama është shprehur se qytetarët mund të thërrasin në interpelancë kryeministrin por edhe ministrat për problemet që kanë, por për këtë duhet të plotësojnë një kusht. "Ka edhe një rubrikë ku përfshihet konsultimi publik, këtu është interpelanca, do u japim mundësinë njerëzve të zakonshëm që të thërrasin në interpelancë kryeministrin dhe ministrat, kuptohet me disa kushte, që të jenë një numër i caktuar anëtarësh. Platforma do të ketë ekranin e vet që do të bëhet interpelanca, sipas tematikës që kërkojnë qytetarët e regjistruar", deklaroi Rama.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

Ne date 11.10.2017 ne orën 16:00 ne zyren e perbaruesit gjyqesor privat **Irisa Tereziu PF** me adresë ne "Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhe, Njesia Tregtare nr.10, Tirane", zhvillohet ankandi per shitjen e pasurise se paluajtshme te llojit "Njesi" me sipërfaqe totale 87.2 m², numer pasurie 15/231-N1, vol.2014-2016, ne zonen kadastrale 8551, me adresë Kavajë.Cmimi ne ankand te pare eshte ne vleren 8,329.553.6 (tete milion e treqind e njezet e nente mijë e peseqind e pesedhjte e tre pike gjashte) lekë.

SHPALLJE ANKANDI

Shoqëria përbarimore "Corrector" shpk, zhvillon ankandin e III-të, për shitjen e pasurisë së paluajtshme, - Trulli + Ndërtesë me sipërfaqe 116.2 m², nga e cila ndërtesë me sipërfaqe 55 m², ndodhur ne Zonën Kadastrale 8562, Nr.Pasurie 2/966, Vol.31, Fq.105, e regjistruar në Zyren Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë; Cmimi i ankandit të tretë është EUR 45,360 (dyzetë e pesë mijë e treqind e gjashtëdhjetë euro). Ankandi zhvillohet dt.30/10/2017, ora 16:00 në adresën, Rruga e Kavajës, Ndetessa 27, Hyrja 1, Kati i III –të, Tiranë. Kontak: cel. 068400061, ose në adresën e email: armels.jole@cnchb.al

NJOFTIM PER SHITJE

Ne Zyren e Perbaruesit Gjyqesor Arjan Palli me adresë Blv.Zogu i I-re, Palli, Agimi, H-2.K-3.Ap.-5-Tirane me dt. 10.10.2017 ora 16.00 zhvillohet ankandi per shitjen e pasurise me nr. 1/197 +3-26.vol8, fq.48, zK 8260, lloji I pasurise apartment me sip. 73 m2 ndodhur ne Tirane, regjistruar ne pronesi te Fazile Stafa.Cmimi me te cilin fillon shitja eshte 40579,2 Euro.

REFORMA VETINGU

Shefja e ONM, dy orë takim me të gjithë anëtarët e institucioneve të drejtësisë

Zbatimi i vetingut, Genoveva Ruiz: Presim ndryshim pozitiv Takimi, çfarë duhet të përmirësojë Shqipëria

Valentina Madani

Shefja e ONM-së, Genoveva Ruiz, takoi dje të gjithë anëtarët e institucioneve të vetingut dhe vëzhguesit e Operacionit Ndërkombëtar i Monitorimit. Kjo mbledhje vjen dy ditë pas takimit të komitetit të Stabilizimit Asociimit. Vetë Ruiz postoi në profilin e saj të "Twitter" foto nga takimi duke shprehur besimin e saj në punën e ekipit. "Krenare të takoj të gjithë anëtarët e institucioneve të vetingut dhe vëzhguesit e ONM-së në Tiranë. Besoj se puna e tyre do të sjellë ndryshime pozitive", shkruan znj. Ruiz Cavallera. Në takimin e para pak ditëve, Komisioni Evropian mirëpriti progresin në këto fusha dhe ka nënvizuar nevojën për të parë rezultate, veçanërisht në reformën e drejtësisë dhe procesin e vetingut. Komiteti i Stabilizimit-Asocimit mori në konsideratë zhvillimet më të rëndësishme të vitit të kaluar në fushat e sundimit të ligjit, reformës së administratës publike, tregtisë, zhvillimit ekonomik, bujqësisë dhe peshkimit, industrisë, tregut të brendshëm, shqërsisë së informacionit, politikave sociale, transportit, energjisë dhe mjedisit. Gjithashtu u rishikua edhe gjend-



Shefja e ONM-së, Genoveva Ruiz, me anëtarët e institucioneve të vetingut dhe vëzhguesit e Operacionit Ndërkombëtar i Monitorimit

ja aktuale në lidhje me zbatimin e ndihmës financiare të BE. Komisioni Evropian përhëndeti përparimin pozitiv në të gjitha fushat dhe theksoi nevojën për të parë rezultate të prekshme, veçanërisht në reformën e drejtësisë dhe në verifikimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe për të vazhduar progresin në të

gjitha prioritetet kyçe, duke përfshirë luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, duke përfshirë kultivimin dhe trafikimin e kanabisit, reformën e administratës publike dhe të drejtat themelore. Për të pesë prioritetet kryesore, Komisioni Evropian theksoi se ka çështje të tjera të rëndësishme që duhet të tra-

jtohen. Në veçanti komisioni pranoi angazhimin e autoriteteve shqiptare në trajtimin e fenomenit të aplikimeve të pabazuara për azil në shtet anëtare të BE-së dhe u kërkoi atyre të vazhdojnë përpjekjet për të adresuar këtë çështje. Komisioni Evropian rikujtoi se bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së

mirë janë një pjesë thelbësore e progresit të Shqipërisë në rrugën drejt integritimit evropian. U theksua roli i Shqipërisë si një partner strategjik për BE dhe u vlerësua pozitivisht përfarimi i plotë i vazhdueshëm me Politiken e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë të BE-së. Më 17 qershor, Parlamenti i Shqipërisë miratoi me 100 vota pro dhe dy kundër listën me 27 anëtarë e komisioneve të vetingut. Në monitorimin e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, tri institucionet e vetingut do të kontrollojnë njerëzit e drejtësisë në drejtimin e pasurisë, lidhjeve me krimin e organizuar dhe aftësitë profesionale.

Letra në Kryeministri

Institucionet: Nuk jemi dakord me ristrukturimin

Ka një amulli në administratë, që pritej të zgjidhej sapo të niste punë qeveria e re. Por, shkruan "Monitor", duket se kjo është shtuar me shumë së fundmi e lidhur me ristrukturimin e njoftuar. Edhe pse u deklarua qartë që shumë institucione do shkrihen bashkohen me të tjera, apo kalojnë në formë drejtorie në ndonjë ministri, ende nuk ka një draft zyrtar të bërë publik për atë se çfarë po ndodh. Por jo të gjithë ata që janë përfshirë në planin e ristrukturimit janë dakord dhe për këtë nuk kanë nguruar të nisin edhe "revoltën" duke zgjedhur rrugën formale të argumentimit dhe pikërisht në Kryeministri. Këtë herë, edhe Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit nuk janë dakord për bashkimin e tyre. Në një takim të bordit drejtues të mbajtur këto ditë është vendosur që sekretariatit të përgjithshëm të Kryeministrit t'i nisët një letër, ku t'i argumentohen arsyet se pse bashkimi i këtyre dy institucioneve ka efekte negative, duke qenë se ato kanë funksione të ndryshme nga njëra-tjetra. Sipas bordit, ky bashkim do të përkthehet në efekte negative për biznesin. Dy drejtoritë nuk janë institucionet e para që kanë shprehur rezervë për propozimin e bërë në planin e ristrukturimit. Bashkimet duket se do të jenë forma më e shpeshtë e ristrukturimit në këtë mandat të qeverisë ku Hipotekat, ALUIZINI dhe Agjencia e Trajtimit të Promës do të jenë bashkë dhe e njëjta situatë lo të përsëritet edhe mes Tatimeve dhe Doganave.

Ambasadori italian: Krimi kërkon goditje të fortë

Kutilo: Grupet kriminale të dalin para drejtësisë

Ambasadori italian, Alberto Kutilo beson se ajo që duhet përmirësuar shpejt në Shqipëri është lufta ndaj grupeve të mëdha kriminale dhe nxjerrja e tyre para drejtësisë. Pas deklaratave të ambasadorit amerikan, Donald Lu edhe Kutilo theksoi nga Korça se kjo gjë deri më tani nuk ka ndodhur. "Italia dhe Shqipëria tashmë bashkëpunojnë prej shumë vitesh në luftën kundër krimit të organizuar, jo vetëm me Shqipërinë, por me të gjithë vendet e botes dhe sigurisht edhe



Ambasadori italian, Alberto Kutilo

Evropës. Bashkëpunimi është i mirë, ka rezultate të mira në luftën kundër kultivimit të kanabisit, por mundet dhe duhet bërë më shumë. Ajo

që besoj se duhet të përmirësohet në Shqipëri është lufta ndaj grupeve të mëdha kriminale dhe mbi të gjitha më pasi këto grupe të dalin para drejtësisë, duhet të gjykojnë dhe nëse janë fajtorë, të dënohen. Kjo deri tani nuk ka ndodhur", deklaroi z.Kutilo. Ambasadori Kutilo foli edhe për integrimin e vendit në Bashkimin Evropian. "Shqipëria e di se për të hapur bisedimet për hyrjen në BE,

duhet të bëjë përparime në 5 fusha kryesore. Ajo po bën përparime, por disa vende në veçanti kërkojnë që të bëjë edhe më shumë", tha Kutilo. Ambasadori italian i bëri këto komente dje pas një takimi në Bashkinë e Korçës me kryebashkiakun Sotirag Filo, ku është biseduar për projekte të përbashkëta në arsim dhe në rikonstruksionin e shkollave.

STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORE "KREON" me PËRMBARUESE GJYQËSORE SUELA METHOXHA

Di 12.10.2017 ora 16:00
Përfundon Ankandit i Dytë për pasuritë:
- Apartament me sipërfaqe 72 m2, me adresë në Rr. "1 Maji" Korçë,
Me çmim 18 144 Euro
- Apartament me sipërfaqe 86.03 m2, me adresë në Pogradec
Me çmim 3 060 000 Lekë
Ankandit Zhvillohet në zyrën e STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORE "KREON", me adr: L.11, Blv.Kryesor (ish kina Iliria), Kati-2, Durrës, Kontakt Cel 0682096575

Njoftim

Permbarusi gjyqësore Genti Bushati nxjerr për shitje në ankand pasurinë :
"Apartament" me sipërfaqe prej 73 m2 e regjistruar në regjistrin hipotekore, vol i, faqe 195, me nr pasurie 2413+1-17, në ZK 8592 me adresë Gytari, Shkoder."
Cmimi fillestar për shitjen në ankand është në masën 2,520,000 (dy milionë e pesëqind e njëzet mijë) lekë.
Shitja e pasurisë do të bëhet (zhvillohet) me datë 16.10.2017 ora 16.16 në Zyrën e përmbarusit gjyqësor Genti Bushati me adresë Rruga Don Bosko, Përballë Gjykatës së rrethit Gjyqësor Shkoder. Personat e interesuar duhet të derdhen përpara fillimit të ankandit 10 % të vlerës si garanci në Bankën BKT dega Shkoder me nr llogarie 41064051, ose në Tirana Bank me nr IBAN AL74 2065 1017 0000 6003 1383 9100 .

Njoftim

Permbarusi gjyqësore Genti Bushati nxjerr për shitje në ankand pasurinë:
"Apartament" me sipërfaqe prej 127.7 m2, e regjistruar në regjistrin hipotekore me nr 82 date 02.06.2011 me vlerë 5 faqe 108 me nr pasurie 16/130+1-8, në Zonen Kadastreale 8597 me adresë, lagja "Pazari", Shkoder ;
Cmimi fillestar për shitjen në ankand është në masën 3,472,000 (tremilionë e katërqind e shtatëdhjetë e dy mijë) lekë.
Shitja e pasurisë do të bëhet (zhvillohet) me datë 13.10.2017 ora 16.16 në Zyrën e përmbarusit gjyqësor Genti Bushati me adresë Rruga Don Bosko, Përballë Gjykatës së rrethit Gjyqësor Shkoder. Personat e interesuar duhet të derdhen përpara fillimit të ankandit 10 % të vlerës si garanci në Bankën BKT dega Shkoder me nr llogarie 41064051, ose në Tirana Bank me nr IBAN AL74 2065 1017 0000 6003 1383 9100 .

REAGIMI



Përrjashtimi i Bashës, Sali Jani: Porosia e Ramës

Deputeti i PD-së, Ervin Sali Jani tha në studion e "News 24" se përjashtimi i z.Basha nga Kuvendi ishte porosi e Ramës. "Neni 46 i rregullores së Kuvendit thotë se çdo deputet që do të diskutojë për rendin e ditës duhet të regjistrohet në sekretari dhe në kemi regjistruar dhe kemi ndjekur të gjitha hapat proceduralë. Unë mendoj se mund të jetë edhe një skenar i Ramës për ta degraduar akoma më shumë dhe për të hequr vëmendjen. Ishte porosi e Ramës dhe sapo nisi diskutimi, Rama tha thuaj që ka mbaruar", - theksoi Sali Jani.



E ardhmja është
emocionuese.
Ready?



Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, Damian Gjoknuri u ka bërë të ditur banorëve të Himarës skemën e kompensimit për pronat që do të preken nga veprat publike. "Objektet janë përfshirë të gjitha në skemën e shpronësimit. Në përputhje me legjislacionin shqiptar, skema e shpronësimit do të vazhdojë dhe përgjithësisht ajo ka funksionuar edhe për projektin. Ndërkaq, banorët i Himarës kanë protestuar për planin urban



istik, duke e konsideruar si "sulm" etnik. Ne si qeveri kemi marrë angazhimin që të sjellim një grup të veçantë

Banorët, protestë gjatë mbledhjes: Veprimi, i qëllimshëm

Gjoknuri në Himarë: Kompensim për çdo pronë

për të bërë matjet e duhura, identifikimin dhe për të ndihmuar këta njerëz që të marrin certifikatat, në rastet kur u takojnë dhe në përputhje me ligjin për rastet kur e kanë të trashëguar apo të fituar sipas ligjit nr.7501. Qeveria shqiptare është e vendosur që projekti të vazhdojë, por njëkohësisht, të gjithë ban-

orët e prekur, qofshin ata me ndërtime apo troje e toka, të kompensohen sipas legjislacionit në fuqi"-deklaroi Gjoknuri në Himarë. "Në përgjithësi, banorët e panë këtë shumë pozitive. Aty brenda ka edhe individë që përfaqësojnë parti politike apo shoqata të caktuara. Kup-tohet, Himara ka probleme më

të mëdha me pronësinë. Unë këtu dua t'u them të gjithë qytetarëve se çështjet e pronësisë së Himarës, si shumë vende të tjera të Shqipërisë, por sidomos në Himarë do trajtohen në vitet në vijim. Ne duam t'i japim një zgjidhje përfundimtare çështjes së pronës këtu. Edhe ajo që unë kam thënë më parë,

dhe që është bërë premtim edhe nga qeveria për një zyrë shërbimi të Hipotekës në Himarë, do ta bëjmë realitet. Zgjidhja e çështjeve të pronësisë është një proces që do të marrë më shumë kohë. Ajo që po flasim tani është një projekt konkret për zhvillimin e qendrës së Himarës dhe që ndikon për gjithë komunitetin. Vlera e këtyre pronave do të rritet, Himara do të jetë një vend më i vizitueshëm dhe komuniteti himariot do të përfitojë nga investimet që do të bëjë qeveria."-tha Gjoknuri.

Marrëdhënia e Tatimeve me biznesin, Sekretariati i Këshillit të Investimeve "zbardh" shqetësimet

Ornela Manjani

Bizneset e mëdha dhe të vogla shprehin shqetësimet në lidhje me vendimet që po merr e pritet të marrë qeveria. Paralajmërimi i kryeministrit Edi Rama për përfshirjen në skemën e TVSH-së edhe të biznesit të vogël, ka vënë në alarm rreth 135 mijë biznese ose 90 % e subjekteve në vend. Kryetari i Shoqatës së Biznesit të Vogël dhe të Mesëm, Albert Nasto, shprehet se "eksperimentimi" që po bëhet për futjen e taksës së TVSH të kjo sipërmarrje, do t'i çojë në faliment. "Ose do rrisim çmimet në mënyrë të atillë të largojmë klientët, që konsumatori me këtë rënie në fuqi blerëse që ka rënë rreth 50% në 2016. Biznesi i vogël të rrisë çmimin e çdo artikulli do të thotë me duart e veta të falimentojë. O do rriten çmimet, ose do falimentojmë. Do mbyllim që më datën 1 janar bizneset", thotë Nasto. Sipas Nastos, kjo ide e hedhur tashmë nga kryeministri Rama, në kuadër të aksionit ndaj informalitetit, nuk është konsultuar me grupet e interesit. Ndërkohë, i pyetur se cili është hapi i radhës, ai përgjigjet: "Në ofrtë se do varrosësh biznesin e vogël e të mesëm, do jenë efekte të pariparueshme për popullin, për qytetarin, për biznesin, për ekonominë shqiptare, në këtë katrahurë ku jemi ne sot", shtoi Nasto.

HUMBJET

Sipas një përlogaritjeje që kanë kryer ekspertët del se fitimet e bizneseve do të bien mesatarisht me 25-40%, ku më të goditurit do të jenë bizneset e shërbimeve, që nuk do të kenë se ku ta shpërkohin TVSH-në.

BIZNESI I MADH

Sekretariati i Këshillit të Investimeve ka nxjerrë rezultatet e anketimit të mbajtur me biznesin, lidhur me shqetësimet që ka ky i fundit kryesisht për marrëdhënien me Tatimet, informalitetin apo rimbursimin e TVSH. Përkishtë këto shqetësimet sekretariati i diskutoi paraprakisht me përfaqësues të shoqatave të biznesit dhe ekspertë fiskalë përpara se ato të bëhen publike në takimin e radhës që



Kryetari i Shoqatës së Biznesit të Vogël dhe të Mesëm, Albert Nasto

do të mbahet së shpejti nga Këshilli i Investimeve. "Gjetjet paraprake të anketës së Sekretariatit të Këshillit të Investimeve "Mbi disa aspekte të klimës së investimeve" u konsultuan me përfaqësues të shoqatave të biznesit dhe ekspertë fiskalë. Ky anketim ka për qëllim evidencimin e ocursës së shqetësimeve kryesore të biznesit, krahasuar me gjetjet e Sekretariatit gjatë 2015-2016, kryesisht lidhur me inspektimin

tatimor dhe marrëdhëniet me administratën tatimore, informalitetin, dhe rimbursimin e TVSH-së. Përfaqësues të dhomave të tregtisë dhe biznesit, ekspertë si edhe përfaqësues të administratës tatimore, komentuan gjetjet paraprake të anketimit dhe dhanë sugjerime e tyre Sekretariatit për t'i konsideruar në version final që do të diskutohen në mbledhjen e radhës së Këshillit të Investimeve", njoftoi Sekretariati.

Shoqëria përbarimorë "STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k., njofton shpalljen për shitjen në ankand të pasurive të paluajtshme:

"Apartment" me sipërfaqe 62 m², me vendndodhje Lagjia "Kongresi i Elbasanit", Elbasan, regjistruar në pronësi të Kujtim Zhika, me Nr. Pasurie 5/27+4-2, Zona Kadastrale 8521, Volumi 11, Faqe 32, lënë si garanci bankës përmes kontratës së hipotekës Nr. 139 Rep., dhe Nr. 40/2 Kol., dhe 19.01.2008. Çmimi fillestar i ankandit është 28,123 Euro;
"Ndërtesës" me sipërfaqe 15.5 m², me vendndodhje Lagjia "Kongresi i Elbasanit", Elbasan, regjistruar në pronësi të Luljeta dhe Sabiola Beqiraj, me Nr. Pasurie 5/61. Çmimi fillestar i ankandit është 22,680 Euro.

Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 11.10.2017.

Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përbarimorë "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7, Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

Biznesi i vogël: Vendosja e TVSH-së na falimenton

"Përlogaritjet, fitimet bien nga 25-40 për qind"

EDI RAMA, KRYEMINISTËR

"Opozita, front në mbrojtje të informalitetit. Ne mbrojmë njerëzit e zakonshëm. Asnjë biznes pa TVSH. Fund mashtrimit me lekët e popullit! Biznesi i vogël do të vijojë të ketë zero tatim-fitimi, por do të duhet të marrë çdo mall me faturë dhe të shesë çdo mall me kupon. Askush nuk mund të hajë më pas shpine as konsumatorin, as shtetin; gjithkush atë që meriton, gjithkujt atë që i takon"-shkruan Rama në "FB".

LULZIM BASHA, KREU I OPOZITËS

"Në vend që të kërcënojë sipërmarrësit e vegjël që punojnë sa për të mbajtur gjallë familjet e tyre, Edi Rama duhet t'u bëjë të ditur shqiptarëve sa para u ka dhënë nga buxheti i shtetit oligarkëve këto katër vjet: oligarkët e shëndetësisë e të ilaçeve, oligarkët e ndërtimit, oligarkët e koncesioneve, oligarkët e naftës dhe të telekomunikacionit"-shkruan Basha në "FB".

PETRIT VASILI

Kryetari i grupit parlamentar të LSI, Petrit Vasili ka akuzuar kryeministrin Rama se duke u vënë në shërbim të oligarkisë, po vret biznesin e vogël. "Kryeministri shkatërron pa mëshirë mijëra biznese të vogla, duke u vendosur TVSH-në. Sekretariati, gjymtyrë dhe instrument i verbër i oligarkisë, e pasuron pafundësisht atë duke i hequr edhe bukën e gojës biznesit të vogël", shkroi dje Vasili.



REPUBLIKA E SHQIPERISE

BANKA E SHQIPERISE

DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT

SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi i pastrim-higjienizimit dhe i dezinfektimit të ambienteve të Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare".

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 13,300,000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi i pastrim-higjienizimit dhe i dezinfektimit të ambienteve të Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 31 Tetor 2017, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Xhensila Kodra

30-vjeçarja: Të gjithë më kanë dhunuar, nusja e re më tha: "Ik, ti nuk ke celebrim"

BERAT
Bashkëshorti im dhe prindërit e tij më kanë dhunuar fizikisht dhe psikologjikisht. Edhe pse Reli më ka tradhtuar dhe ka sjellë në banesë vajzën me të cilën thotë se do martohet, unë nuk do iki nga shtëpia. Këtë e bëj për hatër të djalit që kam me të". Kështu deklaroi dje për "Gazeta Shqiptare" 30-vjeçarja T.Rama. Një ditë pasi "GSH" publikoi denoncimin që ajo kishte bërë në polici, e reja rrëfen me detaje tradhtinë bashkëshortore të Reli H., si dhe marrëdhëniet që ajo ka me familjen e tij.

Ju kenë bërë denoncim në polici për dhunë psikologjike ndaj bashkëjetuesit tuaj, ndërkohë që keni deklaruar se ai ju ka tradhtuar. Kur e mësuar këtë fakt?

Unë nuk e kam ditur më përpara se burri im më tradhtonte. Më përcollti tek njerëzit e mi në Dibër sepse kisha gëzim familjar, fejoja motrën dhe kur jam kthyer sërish në shtëpinë e burrit tim në Urën Vajgurorë, kam parë një femër tjetër aty. Aty mësova se kush ishte kjo femër dhe kur i shpjgoja se kush isha, i kërkova që të dilte që aty që ruhej An-duela. Ajo nuk pranoi dhe më tha se unë nuk isha askush që ta nxirrja prej andej, pasi unë me Relin nuk kisha celebrim.

Sa vite ke që jeton me të dhe pse nuk jeni celebruar?

Ne jemi njohur me shkue-

"Burri më tradhtoi, unë nuk dal nga shtëpia për hatër të djalit"

T.Rama: Reli tek e dashura, unë me vjehrrit e vajzën e tij

si para 5 vitesh. Kam 4 vite e gjysmë që jetoj me Relin. Celebrim nuk kemi bërë, pasi ai ka qenë edhe më parë i martuar dhe me gruan tjetër ka dy fëmijë. Iu zgjatën procedurat e divorcit dhe për këtë gjë ne nuk kemi bërë celebrim.

Bashkëjetuesi juaj ka poha-ruar në polici se ju ka vënë në dijeni që ka një vajzë tjetër dhe me ju ka dashur të ndahej. Si qëndron e vërteta?

Jo, nuk më ka thënë asgjë. Unë i thash që do iki tek njerëzit e mi për sebebin që kisha. I thashë do rri 3 ose 4 ditë dhe do kthehem. Më tha mirë, më dha disa lekë për rrugës dhe më përcollti ai.

Ju ku po jetoni?

Unë vazhdoj të qëndroj në banesën e tij. Unë nuk iki që këtu, sepse për hatër të fëmijës që kam me Relin nuk mund të ndahem prej tij. Dhe ai më ka thënë: "Në rregull nuk do të nda-



hesh, s'të ndaj". Kurse Reli ka ikur dhe jeton në banesën e asaj vajzës tjetër së bashku me të.

Si kanë qenë marrëdhëniet tuaja familjare?

Nuk është se kanë qenë shumë të mira, sepse edhe ne si çdo familje kemi pasur grindjet tona. Të gjitha grindjet vinin prej tij, sepse gruan që la, e akuzonte se ajo e kishte tradhtuar. Ai mendonte se edhe unë po i bëja të njëjtën gjë. I kam shpjguar se mes

nesh nuk do të ndodhte kjo gjë, por ai shumë herë më thoshte se nuk më beson as mua dhe asnjë femër tjetër.

Gjatë kësaj jave ke biseduar me Relin? A ka ardhur në shtëpi?

Ka ardhur vetëm 2 herë. Nuk kam biseduar me të, sepse unë jam me urdhër mbrojtje dhe ai mbase ka frikë të më afrohet se mos unë e denoncoj. **Nëse ai nuk kthehet, si do të vepron?**

Do vazhdoj ta kërkoj vetëm për djalin tonë. Nuk mund të lemë në rrugë një fëmijë.

Si u ndjetë në momentin që gjetët një femër tjetër në shtëpi dhe kur mësuar të vërtetën?

Në atë moment jam tmerruar. Unë isha një viktimë, pasi jo vetëm ai, por edhe vjehrra, vjehrrit dhe ajo vajza tjetër më kanë rrahur shumë keq. Kam qëndruar e fortë dhe gjallë vetëm për djalin tim.

A i denoncovë edhe për dhunë?

Jo, sepse ata më morën telefonin dhe nuk më lanë të flisja me askënd.

Me ju jeton edhe një prej fëmijëve që ai ka me gruan e dytë. Si është marrëdhënia juaj me të?

Vajza e tij është 7 vjeçe dhe ai nuk e respekton fare si të jetë e tija. As të emën nuk e lë ta takojë. Unë me të shkoj

shumë mirë sepse i qëndroj afër.

Po me vjehrrën dhe vjehrrin çfarë marrëdhëniesh ke?

Kam pasur shumë marrëdhënie të mira, deri në momentin që unë erdha nga Di-bra. Nuk e di se çfarë u ka thënë ai që ata m'u kthyen kundër. Më thanë "faji është i yti që e le burrin e ikte".

Kur nisën problemet e tua me Relin?

Në muajin qershor kur vëllai i tij hyri në burg. Kunata e tij erdhi në shtëpinë tonë dhe ai më thoshte pse e pranove në shtëpi. I thashë "ke prindër dhe ata duhet ta nxjerrin dhe jo unë".

Kur Reli jetonte në Greqi, kishte kontakte me të?

Po, flisnim shpesh. Ai erdhi në shkurt, ndenji një muaj e iku prapë se thoshte këtu që s'ka punë e çfarë do hanë fëmijët. Na merre shpesh, madje na niste edhe lekë.

E dije se ai kishte krijuar një lidhje tjetër në Greqi?

Më tha se kishte njohur një vajzë në një kafe në plazh dhe kishte jetuar me të. Më ka thënë se për të i kishte ardhur keq, por jo se do e sillte në shtëpi. Unë mendoj se nga grindjet që ne kemi pasur; tani ma bën për inat që ka gjetur dikë tjetër. Madje, nga grindjet e shpeshta që ne kemi pasur, edhe djali ynë tani është i frikësuar. Ai është 3 vjeç dhe ka filluar të bërtasë natën dhe kërkon që të flejë me dritën ndezur dhe me televizor hapur, sepse nuk e duron dot errësirën nga të bërtiturat që ata më bënin mua.



Implemented by **giz**

Programme: Climate Friendly Integrated Waste and Recycling Management

The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ) is a federal enterprise that supports the German Government in achieving its objectives in the field of international cooperation for sustainable development. The program CFWIM assists Albania to provide affordable and ecological services in the field of solid waste to its population with an orientation at EU standards. In particular support is planned to the following four areas:

1. implementation and further development of the Integrated Solid Waste Management strategy
 2. establishment of waste separation and composting
 3. increase of recycling and reduction of solid waste
 4. effective sector regulation and monitoring
- GIZ supports, in particular, the modernization of the solid waste management system in the Municipality of Himara. To strengthen our local capacities in Himara,

GIZ Office Albania seeks the following staff:

Advisor to support the Municipality of Himara with the implementation of the Solid Waste Management Plan

At average, the advisor will work ¾ of her/his working time located in Himara and ¼ from the project office in Tirana.

A. Responsibilities

- Advisor to the Municipality of Himara, private and NGO stakeholders as well as the general public on the implementation of the new solid waste management plan (waste management technology, processes, management including financing and fees, monitoring and evaluation, documentation). The modernisation will focus on the introduction of solid waste separation at the source, increasing recycling, and treatment of organic waste.
- being the project's focal person for (a) cooperation with the private sector as well as (b) human resource development for municipal staff
- supporting the project manager with project steering
- innovation and knowledge management

The technical solid waste management expert performs the following tasks:

B. Tasks

1. Professional Advising and Consulting

- Supervises development and implementation of project plans and activities in close coordination with counterpart partners within the Municipality of Himara
- Contributes to preparation and implementation of the consultation process, the project's activities, and efforts in the Municipality of Himara
- Assists in defining terms of reference, selection, and supervision of contracted third parties in carrying out project's activities, including educational campaigns Municipality of Himara
- Conceptualises, prepares and implements workshops, seminars, and other events on subjects that are related to the project's field of activities within the Municipality of Himara
- Advises partners and project colleagues as the project's focal person for (a) cooperation with the private sector as well as (b) human resource development for municipal staff and assists with the implementation of activities in these fields

2. Communication and networking

- Co-operates with and ensures regular contacts, dialogues; does PR work and cooperates with relevant organizations, international development partners, non-governmental bodies and persons within the

program's/project's environment as well as with other projects in order to enhance and maintain good working relationships

- Communicates and channels local interests and aspirations and exchanges ideas and information for the benefit of the programme

3. Knowledge management

- Assist in improving the project's knowledge management system and tapping into other knowledge management systems;
- Compiles information about ongoing programme activities and ensures knowledge transfer
- Develops strategies and technical concepts including guidelines, manuals, and procedures, which are ready to be applied
- Prepares reports and presentation materials

4. Management and Coordination tasks

- Contributes to project planning/develops project designs, including preparation, organization and moderation of planning exercises, implementation, management, monitoring, quality management, evaluation, communication, and documentation in regard to municipal services, cooperation with the private sector and human resource development
- Coordinates and prioritises relevant project activities in cooperation with the partners, as well as in organizational preparation and in the implementation of these activities within the Municipality of Himara
- Prepare the budget for project events within the Municipality of Himara

C. Required qualifications, competences and experience:

- masters or bachelor degree relevant to municipal or public service or in environmental/engineering sciences or extended professional working experience in or with the Albanian municipal or public service
- at least 5 years of work experience in a relevant area
- experience in municipal or public service provision or extensive work experience inside or with development partners
- Ability to support a multi-task, multi-discipline project team
- Fluency in written and spoken Albanian and good command of the English language; command of German language would be an additional asset
- Able to work in a team as well as independently
- High level of reliability
- A personality with excellent social and communication skills
- Clean driving licence for cars being a very reliable driver

Contract conditions:

- Full-time employment
- Project offices in Himara and Tirana
- Assignment period: 01.11.2017 until 31.08.2019

Please forward your application until 19.10.2017 to GIZ Office Albania by E-Mail: giz-albanien-hr@giz.de including the following information: Application letter, CV in English (Europass format), references.

Only short-listed candidates will be contacted for interviews. Short-listed candidates will be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates.

GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!

Mbesa e Besnik Sulkut: Ja biseda e fundit që bëra me dajën, ai nuk mendonte më as për familjen

"Besniku ishte betuar që do hakmerrej për të vëllain"

Sara Alliu: Nuk e kapërceu humbjen e Durimit në Holandë

Ina Allkanjari

Daja im, Besnik Sulku ishte betuar se do të marrte hak, sepse ka qenë shumë i lidhur me vëllain e tij, Durimin dhe e ka pasur pjesë të shpirtit". Kështu deklaroi dje në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", mbesa e Besnik Sulkut, Sara Alliu. Ajo pohon se konfliktet me familjen Doçi kanë nisur shumë vite më parë, për shkak të xhelozisë. Gjatë intervistës, e reja tregon edhe për takimin e fundit me dajën e saj, Besnikun, që e konsideronte si babain i saj.

Dy vite më parë daja juaj, Besnik Sulku, u bë pjesë e një atentati ku ndërroi jetë edhe ai vetë. Pse ndodhi kjo ngjarje?

Kjo ndodhi prej një xhelozie të tepërt nga pala kundërshtarë, pasi kanë qenë shokë që në fëmijëri. Nuk është diçka që është bërë për motivet e shumta që



Pamjet nga vendi ku ndodhi atentati

është përfolur deri më tani dhe që unë nuk dua t'i përmend, por mund të them që kjo ngjarje ka nisur që në fëmijëri dhe xhelozia e tepërt i ka sjellë deri në këtë pikë, sa që gjërat janë rritur me vite.

Është pohuar se Besniku vrau Mentor Lufin (Doçi) për hakmarrje. Si qëndron e vërteta?

Përsa i përket pjesës së hakmarrjes, daja im Besnik

Sulku ishte betuar se do të marrte hak, sepse ka qenë shumë i lidhur me vëllain e tij, Durimin dhe e ka pasur pjesë të shpirtit. Që pas humbjes të së vëllait, ai u rëndua shumë psikologjikisht dhe ka qenë një moment që nuk ka mundur as për familjen e tij. Nuk diskutohet që nuk donte as jetën e tij.

A keni pasur dijeni për marrëdhënien që Besniku

ka pasur me italianin Salvatore Letizia, për të cilin u tha se bashkëpunuan në ngjarje?

Nuk diskutohet që kemi qenë në dije të shoqërisë së tyre, pasi ata ishin shokë prej vitesh, e quante vëlla. Si sillej Besniku përpara se të ndodhte tragjedia?

Këtë gjë ai e priste, pasi ishte shumë rëndë psikologjikisht dhe mendonte veç që të merrte gjakun e të vëllait. Ai nuk mendoi më as për ne, as për mua që më ka rritur dhe isha si vajza e tij. Sepse unë jam rritur në duart e atij dhe të Durimit, por sidomos të Besnikut. Kjo, pasi unë nuk e kam pasur babain. Nuk mendoi për më gjatë.

Përsa i përket dajës suaj, Durim, si e morët vesh vdekjen e tij?

Ne e dinim sikur kishte ndodhur një aksident dhe jo që e kishin vrarë. Siç na kanë thënë në familjarët, pasi nuk donim të na tronditnin. Por më vonë mësuam që e kishin vrarë, kjo pasi doli edhe në media dhe u bë shumë e madhe. Por di të them se Durim Sulkun e ka vrarë Markelian Doçi dhe kjo gjë nuk diskutohet për asnjë lloj arsye.

Keni pasur kontakte pas vrasjes së Besnikut me familjarët e Doçit?

Jo aspak, asnjë lloj kontakti.

A e kujtoni momentin e fundit që keni nga daja juaj, Besniku?

Momenti i fundit dhe shumë i bukur që unë kam pasur me të është para se të nisej në Holandë, pasi vdiq dajë Durimim. Unë e dija pak a shumë që ai nuk e donte më jetën e tij dhe në një moment e ula afër meje dhe i thashë "të lutem mos më lër vetëm,

Kleji Doçi: U ndodha rastësisht në ngjarje

Nëna e Durim dhe Besnik Sulkut:

Dua drejtësi për djemtë e vrarë


Në Gjykatën e Krimeve të Rënda vazhdojnë seancat për vrasjen e trefishtë të ndodhur në "Bulevardin Zogu i Parë" në 2015-ës, ku humbën jetën Besnik Sulku, Mentor Lufi (Doçi) dhe Gerti Goxhaj. Hetuesit dyshojnë se ngjarja është e lidhur me vrasjen e Durim Sulkut, vëllait të Besnikut. Ai u ekzekutua në Roterdam të Holandës në parkimin poshtë apartamentit ku jetonte në prill të vitit 2015. Prokuroria po e heton ngjarjen për motive hakmarrjeje. Në seancën e djeshme u vendos të thirren 7 dëshmitarë holandezë për atentatin e kryer ndaj Durim Sulkut. Të dyshuar kryesor për masakrën e trefishtë janë vëllazërit Klevis dhe Markelian Doçi si dhe shtetasi italian, Salvatore Letizia, i njohur me nofkën Picolo Letizia. Ky i fundit akuzohet për vrasjen e Mentor Lufit. Ndërsa, sipas prokurorisë, vëllazërit Doçi kanë ekzekutuar Besnik Sulkun. Nga hetimet rezultoi se italianin ishte mik i Besnikut, ndërsa është akuzuar si vrasës me pagesë. Ndërkohë, mbeten të dëshmojnë shtetasit holandezë, të cilët kanë dijeni për vrasjen e Durim Sulkut, çka solli dhe ngjarjen e ndodhur në Shqipëri. Ndërkaq, në një prononcim për mediat, Gjysere Sulku, nëna e dy djemve të vrarë, Durim e Besnik Sulku, thotë se e ka të vështirë të shohë në sy dy të akuzuarit sa herë që ajo shkon në gjykatë për të ndjekur seancat. E mihuara deklaroi se nuk do të ndalet derisa drejtësia të vishet në vend. "Markelian Doçi më ka vrarë të dy çunat. Nëse ai nuk dënohet me dënim përjetë, unë do të kërkoj drejtësi edhe më lartë", theksoi ajo. Në seancën e djeshme u lexua edhe dëshmia e Klejvi Doçi. Ai ka deklaruar se: "U ndodha rastësisht në ngjarje. Po udhëtoja në makinë me vëllain tim, Markelianin. Përpara nesh ishte xhaxhai me makinë. Pamë dy persona që qëlluan në drejtim të tij. Markelian i aksidentoi ata me makinë. Zbrita me të shpejtë dhe iu afrova xhaxhait tim, Mentorit. I preka pulsin dhe ishte ende gjallë. Të shtënat vazhdonin. Duke menduar se xhaxhai është gjallë, vendosa të pranoj vrasjen e Durim Sulkut, në të cilën nuk kam gisht. Vetëm në gjykatë e mësova se xhaxhai kishte ndërruar jetë, tri ditë më vonë kur dola për masë sigurie në gjykatë". Gjykata ndërkohë vendosi të mos pranojë si prova procesverbalet e marrjes në pyetje të vëllazërit Doçi pa praninë e avokatit dhe që mbajnë firmën e ish-zyrtarit të lartë të policisë, Dritan Xhindoli, i arrestuar së fundmi për qëllime ekstradimi drejt Italisë.

mos lër vetëm asnjërin nga ne. Pa ty gjithçka është bosh". Dhe sinqerisht ashtu doli, gjithçka ngeli bosh, sepse Besniku ishte babai im për mua, pasi siç e thash, unë nuk e kam pasur babain. Momentin e fundit që isha me të, më ka përqafuar dhe më ka thënë që "ty nuk do të të lër kurrë vetëm".

Një thirrje për drejtësinë?

Dua që drejtësia të vihet në vend, edhe pse në Shqipëri kjo gjë ndodh pak, por i mbaj shpresat tek drejtësia e Holandës që do të bëjë diçka. Nuk është e arsyeshme që

gjyqi i djemve dhe i italianit të shtyhet kaq shumë. Kjo sepse po shtyhet seancë më seancë pa logjikë dhe pa arsye. Një nga arsyet e dhëna ka qenë një nga ata djemtë nuk ka qenë mirë për arsye shëndetësore. Kanë edhe dy avokatë që po bëjnë çdo gjë që të shtyhet gjyqi dhe mua kjo më duket e logjishme. Nuk jam vetëm unë dhe familjarët e mi që themi se Klejvi Doçi dhe Markelian Doçi i kanë vrarë dajat e mi. Kanë qenë shumë dëshmitarë që e kanë parë këtë ngjarje. Logjikisht daja im nuk do shkonte të vriste Mentor Doçin, pa e pasur të sigurt që ai e ka urdhëruar vrasjen e Durimit. Por çdo gjë është e hapur dhe do ishte një nga skandalat më të mëdha në Shqipëri nëse ata të dy do dilnin me një dënim të ulët apo të prafjshëm, se kështu si po rrjedhim gjërat, edhe mund të ekzistojë si mundësi.



ANNOUNCEMENT

Private Vocational Training Provider – Call for Proposal and Expression of Interest

The GIZ Program for "Sustainable Economic and Regional Development, Employment Promotion and Vocational Education and Training" in Albania (GIZ ProSEED) under the component of Technical Vocational Education & Training, will cooperate with Private Vocational Training providers in the country, with the aim to scale-up VET programs, complementary to the courses offered by Public VET providers.

In this respect the programme is conducting a Call for Proposals and Expression of Interest from 26 September – 15 October 2017.

The Call for Proposals and Expression of Interest shall help to identify private entities that can offer Vocational Training (VT) in line with the requirements below:

- training/courses with 3 - 6 months training duration for about 50 - 150 participants, targeting young people at the age of 19-34 years. 40% of the participants are female and 30% of the trainees are young returning migrants from EU countries.
- demand-driven and work-based VT short-term courses relevant to the local labour market that lead to employment of the stated target group. The proposals should explain how employment of min. 50% of the participants after completing the training measure can be achieved.
- There is no limitation in terms of geographical location, though high preference will be given to the locations where available vocational training offer by either public or private VET providers is non-existent or very limited. The courses should be in line with the following prioritized sectors – ICT, tourism, agro-processing, textile & footwear, innovative/creative crafts.

The 5-7 proposals that are to be selected through this call shall receive financial support in the amount between 30,000 – 50,000 EUR (equivalent in ALL). The number of contracts is flexible until the programme budget of 250,000 EUR assigned for this activity is allocated. The project implementation timeframe is up to 1 year (12 months).

Selection Procedure:

First step: All Call for Proposals and Expression of Interest received by applicants will be evaluated based on the eligibility and technical criteria described in the evaluation grid.

Second Step: The potential qualified candidates will be invited for an interview and required to submit a budget proposal.

Third Step: Contracts will be awarded to the 5-7 companies with best technical and financial offer.

Please, send an email to giz-albanien@giz.de, to receive Expression of Interest format and Evaluation Grid.

For further questions, please, contact us via email to giz-albanien@giz.de during the period 26 September-14 October 2017.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARRUESVE GJYKËSORË PRIVATE
SHOQËRIA PËRMBARRIMORE "EXECUTORIS LITUM" (ECL LIT) sh.p.k.

Shoqëria Përbarrimtare "Executores Litum" sh.p.k. do të zhvillojë ankandin për pasuritë e pallogjistme:

1. Pasuria "Tualet" me sip. 2950 m² + ndërtesë me sip. 2275 m², e regjistruar në ZVRRP Tiranë me ZK. 2679, me nr. pasurie 5024, vol.35, faqe 58 dhe pasuria "Tualet" me sip. 1050 m² + ndërtesë me sip. 507 m², e regjistruar në ZVRRP Tiranë me ZK. 2679, me nr. pasurie 5023, vol.35, faqe 57 e ndodhur në Miroçin, Tiranë, në propozitë të "DISTRIBRANOS" sh.p.k. Çmimi me të cilin do të fillëzohet ankandi është në vlerën 1.026.448 Euro.

2. Pasuria "Ari" me sip. 1.400 m², e regjistruar në ZVRRP Tiranë me ZK. 2679, me nr. pasurie 4716, vol.4, faqe 80, në propozitë të "DISTRIBRANOS" sh.p.k. Çmimi me të cilin do të fillëzohet ankandi është në vlerën 56.448 Euro.

Ankandi do të zhvillohet në datë: 12.10.2017 ora 14:00, në zyrën përmbarrimore "Executores Litum" sh.p.k. me adresë Blv "Zhan Dark", Kulla 1 Teknopark, shk. 1, kati 4, ap.10, Tiranë.

Rreth 20 mijë arsimtarë do i nënshtrohen trajnimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies

Premtimi, Nikolla: Pagat e mësuesve do të rriten me 40%

Voltiza Duro

Pagat e mësuesve të arsimin parauniversitar do të pësojnë një rritje rreth 40% brenda këtij mandati katërvjeçar të qeverisë së re. Nga kjo shtesë do të përfitojnë rreth 35 mijë arsimtarë në të gjithë vendin. Lajmi është bërë i ditur nga ministria e Arsimit, Lindita Nikolla, e cila u shpreh se mësuesve do t'u ofrohet një mbështetje e madhe financiare nga qeveria. Treguesi i parë mbi rritjen e pagës do të përcaktohet në buxhetin e 2018-ës. "Ne do rrisim rrogat e mësuesve me rreth 40%. Aktualisht një mësues paguhet me 45 mijë lekë të rinj, ndërsa sipas planit të qeverisë deri në vitin 2021 pritet që paga të shkojë në nivelin e 63 mijë lekëve të rinj", u shpreh ministria. Sipas saj, mësuesit me arritje maksimale do të përfitojnë edhe paketa mbështetëse, pasi mësuesit përbëjnë shtyllën e cilësisë në arsim dhe pikërisht te kjo e fundit du-

"Brenda mandatit do të arrijë 63 mijë lekë"



Ministria e Arsimit, Lindita Nikolla gjatë takimit me mësuesit

het investuar fuqishëm që të arrihen rezultatet e dëshiruara. "Profesioni i mësuesit është një mision nobel. Në

100 ditët e para të qeverisjes ne do të zhvillojmë një proces kualifikimi për mësuesit, një sistem kualifikimi

që synon aftësimin e tyre të mëtejshëm", - tha Nikolla. Ajo gjithashtu nënvizoi se për 3 muajt e parë të qever-

isjes, 2200 mësuesit që kanë rezultuar dobët në vlerësimin e vitit 2016, do të trajnohen nga pedagogët e profesionistët më të mirë dhe nuk do të pushohen nga puna. "Tashmë ne kemi hartën e nevojave për çdo mësues të Shqipërisë dhe do të nisim një kualifikim që nuk shkon për të shitur e për të blerë kreditë që ca agjencitë të pasurohen, por një trajnim që orientohet pikërisht nga nevojat e çdo mësuesi. Që në 100-ditëshin e parë ne do të mundësojmë nxjerrjen nga niveli i dobët i rreth 2200 mësuesve", tha ministria. Ajo shtoi se në vazhdim do të bëhen trajnime kualifikuese edhe për 20 mijë mësues të tjerë në rang vendi me synim identifikimin e korrigjimin e atyre elementeve që ndikojnë negativisht në mësimdhënie.



DHURATA MYRTOLLARI, ME ÇMIM 'MËSUESJA E VITIT'

Për herë të parë në vendin tonë, është dhënë çmimi kombëtar "Mësuesi i Vitit", të cilin e ka fituar Dhurata Myrtollari. Ky çmim është dorëzuar nga ministria e Arsimit, Lindita Nikolla, e cila tha se mësuesja Dhurata do të përfaqësojë Shqipërinë në fazën tjetër të konkurrimit në nivel ndërkombëtar. "T'i kthejmë sytë tek të gjithë ata mësues që nuk e ndjejnë dorën e shtetit, qeverisë, shoqërisë për t'i mbështetur dhe qenë krah tyre në realizimin e këtij misioni kaq fisnik", tha ministria. Ndërkaq, Dhurata Myrtollari tha se një mësues i mirë nuk duhet të ndalojë së përmirësuar profesionalisht për t'u përshatur kohës e situatës. Ky çmim u jepet të gjithë atyre mësuesve që dallojnë për rishtë që sjellin në mësimdhënie.



The European Union Delegation to Albania is looking for a

SECRETARY

Functions include general administrative and secretarial support to the Finance, Contracts and Audits section

For complete information and application, please refer to:

https://eeas.europa.eu/delegations/albania_en

"Jobs & Funds" > "Jobs, Internships" > "Job offers"

We offer:

- Multicultural working environment
- Competitive salary
- Benefits by law

For all questions please refer to https://eeas.europa.eu/delegations/albania_en ("Jobs & Funds") or contact us via DELEGATION-ALBANIA-JOBS@eeas.europa.eu

Deadline for applications: 20/10/2017

Senati: Kemi të gjitha kapacitetet e nevojshme

Akreditimi, Universiteti i Tiranës, grup pune për plotësimin e rekomandimeve

Pas vendimit të Bordit të Akreditimit, sipas të cilit, Universitetit të Tiranës iu dha një vit akreditim. Senati Akademik i këtij institucioni arsimor shqyrtoi rekomandimet e përcaktuara. UT vendosi ngritjen e një grupi pune të përbërë nga senatorë përfaqësues të të gjitha fakulteteve dhe studentëve, për të përmbyshur brenda afatit të përcaktuar të gjitha rekomandimet e Vendimit të Bordit të Akreditimit. Ky universitet në deklaratën e tij thekson se ka të gjitha kapacitetet institucionale, akademike, njerëzore, përvojën 60-vjeçare në arsimin e lartë për të përmbyshur kushtet e vendosura. Senati Akademik i UT-së është shprehur kundër çdo



lloj keqpërdorimi dhe kufizimit në publikim të kësaj procesi në funksion të konkurrencës së pandershme. "Universiteti i Tiranës mbetet i përkushtuar për ruajtjen dhe përmbyshjen e standardeve më të larta akademike, shkencore dhe institucionale për të konkurruar denjësisht brenda dhe jashtë vendit", - citohet në deklaratën e UT-së. Gjithashtu, senati ka sqaruar se Universiteti i Tiranës është tashmë i akredituar, me rekomandime për t'u përmbyshur brenda një periudhe 1-vjeçare. Ky është akreditimi institucionale, që përfshin aspekte teknike të funksionimit të institucionit dhe jo programe/akademike.

Hap dyert çerdhja më e re në "Komunën e Parisit" në kryeqytet

Një çerdhe e re ka çelur dyert për vogëlushët e zonës së "Komunës së Parisit" në Tiranë. Ambientet e reja të kësaj shtëpize për fëmijë u inspektuan nga kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj; ministri për Diasporën, Pandeli Majko; ambasadori turk në vendin tonë, Hidayet Bayraktar dhe përfaqësues të kompanisë donatore. Kryebashkiaku thek-

soi se po shikohet mundësia që bashkia të marrë edhe hapësira të tjera me qira për t'i vënë në dispozicion të fëmijëve dhe për të zbutur sado pak kërkesën e prindërve. Ai lajmëroi se po planifikohet që të gjitha shkollat e reja që do të ndërtohen të jenë të pajisura edhe me ambiente dhe infrastrukturën e nevojshme për më të vegjëlit.

Lista emërore në Shkodër, Malësi e Madhe dhe Pukë. Kompensimi fizik e financiar, në rend kronologjik

ATP, statusi i secilës pronë në Shkodër

Emrat e pronarëve, sipërfaqja e pretenduar dhe sa kompensohet

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtitimit të Pronës ka përditësuar regjistrin e saj elektronik për dosjet e pronave në të gjithë vendin. Çdo trashëgimtar pronash ka mundësi të lexojë në "Gazetën Shqiptare" statusin e dosjes së tij dhe problematikën e dokumenteve që mund të ketë secili pronar. Regjistri elektronik mban të

dhëna të detajuara për çdo aplikim dhe çdo proces që ka ndodhur me pronat që nga viti 1993 dhe deri tani për qarkun e Shkodër. Secila nga dosjet përmban emrin e subjektit të shpronësuar si dhe emrin e subjekteve që e pretendojnë atë pronë. Në dosje pasqyrohen sipërfaqja e pretenduar si dhe lloji i pasurisë, sipërfaqja e njohur, sipërfaqja e kthyer apo e kompensuar. Ndërkohë që pasqyrohen edhe të gjitha vendimet e Komisioneve dhe Zyrave Rajo-

nale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për secilin subjekt, bashkë me vendimet gjyqësore dhe problematikat e secilës dosje. "Gazeta Shqiptare" nis sot publikimin e pjesës së katërt të listës së veprimeve që janë kryer me dosjet e pronave të qarkut të Shkodër. Të gjithë të interesuarit njihen gjithashtu edhe me problematikat që mund të ketë dosja e tyre, siç është mungesa e dokumenteve të caktuara. Ndërkohë, Agjencia e Trajtitimit të

Pronave ka marrë në shqyrtim dosjet në qarkun e Elbasanit, të cilat janë në proces shqyrtimi. Regjistri i dosjeve në shqyrtim pasqyron numrin e dosjes, emrin e subjektit të shpronësuar, kërkesin, llojin e pasurisë si dhe të dhënat në lidhje me sipërfaqen e njohur, sipërfaqen e kthyer dhe sipërfaqen e kompensuar. Në regjistrin janë edhe të dhënat për çdo dosje për vendimet e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si dhe prob-

lematika që ka çdo dosje, e cila pasqyron mangësinë në dokumentacion. Sot publikohet regjistri elektronik i pronave në qarkun e Shkodrës, ku përfshihen Shkodra, Malësia e Madhe dhe Puka. Dosjet ndodhen në Agjencinë e Trajtitimit të Pronave në proces shqyrtimi dhe do të trajtohen me ligjin e ri. Vendimi do të merret sipas rendit kronologjik të kërkesave dhe kompensimi do të shpërndahet sipas këtij rendi, me përjashtim të rasteve

kur subjekti kërkon të përfitojë nga pagesa e përshpejtuar, ose kërkon të jetë pjesë e tenderit për kompensimin fizik në bazë të pronave që ka vënë në dispozicion ATP-ja. ATP-ja do t'i japë përparësi kompensimit të trullit. Kompensimi për ish-pronarët për tokën trull, sipas zërit kadastral të vitit 1945 dhe vendimi do të merret sipas rendit kronologjik të kërkesave dhe kompensimi do të shpërndahet sipas këtij rendi, me përjashtim të rasteve

LISTA E VEPRIMEVE QË JANË KRYER ME DOSJET E PRONAVE TË QARKUT TË SHKODRËS (PJESA E KATËRT)

(Vijon nga numri i djeshëm)

Emri (Subjekti i shpronësuar)	Mbiemri (Subjekti i shpronësuar)	Emri (Subjekti Kërkuar)	Mbiemri (Subjekti Kërkuar)	Sip. E pretenduar, m2 & lloji i pasurisë	Zona Kadastrale	NR I Vendimit I KKKP, ZRKKP	Sip. E Njohur/ Mosnjohur e M2	Sip. E Kompensuar M2	Problematika
Simon	Luka	Hile	Lukaj	2300m2 truall	Rranxa / 3205	345	2300	1300	Ka vert. kada stre Ka harte
Gjon ; Mrika	Markagjoni	Dede	Markagjoni	2500m2	Lac,Vau Dejes / 8598	344	2500		Ka VFJ+Harte
				Shtepi pa sip. 2000m2 truall 8950m2 truall	Lac,Vau Dejes / 8598	344/1	18950 +1 shtepi pa sip.		Ka VFJ+Harte
Ahmet	Dufalia	Mustaf	Dufalija	17000m2 truall	Mjede / 2702	343	10700	5000	Ka VFJ+Harte
Alush	Gradeci	Isa	Gradeci	Shtepi pa sip. 700m2 truall	Barbullush / 1100	342	700		Ka dokum.ka dastrak Ka harte
Selim	Brahimi	Vasfije	Duli	1000m2 truall	Mjede / 2702	341	1000	1000	Ka dokum.ka dastrak Ka harte
Dan	Bala	Adem	Bala	3000m2 truall	Dobrac / 1495	340	3000	3000	Ka dokum.ka dastrak Ka harte
Myftinia Shkoder		Myftinia Shkoder		2800m2 truall 2600m2 truall 2700m2 truall 2000m2 truall	Kullaj / 2318	399	10100	26010	Ka vert. kada stre Ka harte
Myftinia Shkoder		Myftinia Shkoder		7250m2 truall 3350m2 truall 2900m2 truall	Shkjez / 3389	426	13500	2900	Ka vert. kada stre Ka harte
Myftinia Shkoder		Myftinia Shkoder		5180m2 truall 3500m2 truall 220m2 truall 1200m2 truall 1900m2 truall	Boks / 1240	398	12000	220	Ka vert. kada stre Ka harte

(Vijon nesër)

Emri (Subjekti i shpronësuar)	Mbiemri (Subjekti i shpronësuar)	Emri (Subjekti Kërkuar)	Mbiemri (Subjekti Kërkuar)	Sip. E pretenduar, m2 & lloji i pasurisë	Zona Kadastrale	NR I Vendimit I KKKP, ZRKKP	Sip. E Njohur/ Mosnjohur e M2	Sip. E Kompensuar M2	Problematika
Myftinia Shkoder		Myftinia Shkoder		11500m2 truall 7750m2 truall	Berdice / 1157	395	8900		Ka vert. kada stre Ka harte
Myftinia Shkoder		Myftinia Shkoder		11300m2 truall 1000m2 truall 3000m2 truall	Trush / 2664	397	15300		Ka vert. kada stre Ka harte
Pjeter	Prela	Gjergj	Duka	11400m2 truall	Dajc / 1435	394	8450	5500	Ka vert. kada stre Ka harte
Xhemal	Bushati	Esat	Bushati	15000m2 truall	Bushat / 1329	393	10500	10500	Ka vert. kada stre Ka harte
Bajram	Prroi	Ferit	Prroi	9200m2 truall	Shtoj i vjeter / 3429	392	9200	9200	Ka vert. kada stre Ka harte
Rabije	Golemi	Firdus	Golemi	18000m2 truall	Berdice / 1157	391	10800	10000	Ka vert. kada stre Ka harte
Rasim	Ymeri	Rasim	Kubashoviq	15000 m2 truall	Shtoj i Ri / 3428	129	3000	3000	Ka vert. pron esie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Mark	Rrotani	Shtjefen	Rrotani	2750m2 truall	Rranxa / 3205	128	2750	2750	Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Shaqe	Llupi	Sander	Sheldia	5875m2 truall + fabrike gelqereje	Shiroke / 8591	127	5870		Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Tom	Frani	Prek	(Frani)	3800m2 truall	Luarze / 2500	126	3800		Ka vert. pron esie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Bisho	Pjeshka	Enver	Osmani	9000m2 truall	Shtoj i Ri / 3428	125	9000	9000	Ka vert. pron esie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua

INTERVISTË ME AMBASADORIN E KUBËS NË SHQIPËRI, Z. PEDRO PABLO SAN JORGE

"Në interesin tonë, të vendosim marrëdhënie në të gjithë sektorët"

"Promovoj dashurinë mes popujve tanë"

Aleksandra Kola

Kuba e Shqipëria janë në stadin e përforcimit të marrëdhënieve reciproke". Kështu ka deklaruar në një intervistë për "News 24", ambasadori i Kubës në Shqipëri, z. Pedro Pablo San Jorge. Sipas tij, ka shumë mundësi bashkëpunimi mes dy vendeve dhe Kuba do ta avancojë këtë marrëdhënie.

Si i vlerësoni marrëdhëniet aktuale Kubë-Shqipëri?

Para së gjithash, dua të falënderoj të gjithë ekipin e "News 24" për këtë intervistë. Për mua është një kënaqësi të vij përsëri në Tiranë. Kam 3 vjet që përfaqësoj Kubën si ambasador në Shqipëri dhe mund të pohoj se në këto momente, marrëdhëniet diplomatike midis Shqipërisë dhe Kubës janë shumë të mira. Ne jemi



Në foto: Ambasadori i Kubës në Shqipëri, z. Pedro Pablo San Jorge



Në foto: Ambasadori i Kubës në Shqipëri, në një intervistë për "News 24" me gazetaren Aleksandra Kola

duke punuar për të forcurur dhe zgjeruar edhe më tej këto marrëdhënie dhe për

këtë arsye, ne sot kemi pasur takime me autoritetet më të larta të vendit. Është

në interesin tonë që të vendosim marrëdhënie në të gjithë sektorët e mundshëm si në nivel Presidence, në nivel qeverie, në nivel parlamentar. Gjithashtu, për të punuar për disa marrëveshje, që ne tashmë i kemi përgatitur që të avancojmë edhe më tej në këtë bashkëpunim. Dëshëm ta shfrytëzojmë këtë mundësi për të promovuar mundësitë që ekzistojnë në vendin tonë për biznesin shqiptar, si pasojë e hapjes që ka pësuar politika e qeverisë sonë gjatë viteve të fundit ndaj investimeve të huaja. Sepse ne mendojmë që në Shqipëri ekzistojnë ndërmarrje me potencial dhe duhura dhe me konkurreshmërinë e duhur për të hapur dhe investuar kapitalet e tyre në Kubë. Gjithashtu, ka edhe fusha të tjera ku ekzistojnë mundësitë për zgjerimin e bashkëpunimit siç është kultura, sporti dhe në mënyrë shumë të veçantë sektori i shëndetësisë. Shohim se ka një gatishmëri dhe disponibilitet të mirë nga ana e autoriteteve shqiptare për ta zgjeruar këtë lloj bashkëpunimi. Po kështu, edhe autoritetet kubaneze e kanë këtë disponibilitet për të shtuar marrëdhëniet me Shqipërinë, sepse këto marrëdhënie janë historike dhe tradicionale midis popullit kubanez dhe popullit shqiptar.

Unë kam qenë në kontakt me temat që diskutohen dhe zhvillohen aktualisht në Shqipëri dhe mendoj që është një nga temat me shumë interes goftë për popullsinë, goftë për aktualitetin në Shqipëri dhe si ambasador në këtë

vend, unë dëshiroj dhe uroj që të kalohet me sukses kjo lloj reforme dhe të bëhet për të mirën e popullit në radhë të parë, në mënyrë që të arrihen rezultate të kënaqshme në sektorin e drejtësisë.

Cfarë vlerësoni më shumë në Shqipëri?

Vërtet është një pyetje shumë interesante. Ka shumë gjëra pozitive që ne kemi parë në Shqipëri. Është një vend që na ka bërë shumë përshtypje, na ka impresionuar shumë dhe kjo gjë për historinë e saj, për traditat, për kulturën e saj, por nëse ka diçka që duhet ta veçojmë, që mua më ka bërë shumë përshtypje është dashuria dhe afriteti që ndjen populli shqiptar për popullin kubanez dhe për Kubën. Në të gjitha nivelet që kemi qenë, unë mendoj që ekziston kjo ndjenjë dhe ne si parti politike kemi prituri në nivel ministrish delegacione dhe e kemi perceptuar dhe kemi parë këtë lloj dashurie dhe afriteti ndaj popullit kubanez, sepse kemi të bëjmë me disa marrëdhënie, që kanë ekzistuar prej shumë vitesh, kanë qenë marrëdhënie shumë të thella. Shumë kubanezë e kanë vizituar Shqipërinë, kanë vizituar Tiranën dhe shumë shqiptarë kanë vizituar Kubën. Kjo gjë ka çuar në krijimin e një marrëdhënieje shumë solide. Është objektivi ynë thelbësor që unë si ambasador të përpiqem që t'i promovoj, t'i mirëmbaj dhe t'i ruaj këto lloj marrëdhëniesh dashurie, simpatie midis popujve tanë.

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

GSH
www.gsh.al

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

Tashmë edhe lundroni!

GAZETA SHQIPTARE

KRIZA POLITIKE, SOT TAKIMI RAMA-BASHA

Agnes Dolak: Ja refrejt dëshira në Mollat me Felice Romano

Shumë për Kubën, Pedro Pablo San Jorge

BLUE TOOTH

DORINA GEGEJI çdo ditë në gazetë! Në muajt e kaluar, ajo ishte në listën e personave të kësaj gazetë!

MILIO

A mëmën Shën Tonën një moment në Shqipëri!

Në Shqipëri po flitet shumë për reformën në drejtësi. A mendoni se kjo do të jetë një reformë e suksesshme?

Unë kam qenë në kontakt me temat që diskutohen dhe zhvillohen aktualisht në Shqipëri dhe mendoj që është një nga temat me shumë interes goftë për popullsinë, goftë për aktualitetin në Shqipëri dhe si ambasador në këtë

Lirohet Genti Nderjaku, prokuroria: Pistoletën e kishte me leje për brenda banesës

U arrestua për armë pa leje, gjykata lë në burg "ushtarin" e Lul Berishës

Marjel Fierza: Armën e gjeta në një depozitë uji, do e dorëzoja

Klodiana Haxhiaj

DURRËS

Gjykata e Shkallës së Parë e Durrësit dje vendosi masën e sigurisë "arrest me burg" ndaj 30-vjeçarit Marjel Fierza dhe "detyrim paraqitje" për shokun e tij, Genti Nderjaku, të cilët u arrestuan katër ditë më parë për armëmbajtje pa leje gjatë një operacioni të policisë në Durrës për goditjen dhe mbajtjen nën kontroll të grupeve kriminale. Seanca gjyqësore u zhvillua rreth orës 10:15 nën masa të rrepta sigurie, ndërsa forcat policore kishin "blinduar" gjykatën. Në sallën e gjyqit ishin të pranishëm dhe të afërmit e dy djemve që u kapën me pistoletë në mjetin tip "Porsche". Gjatë fjalës së tij, përfaqësuesi i akuzës,



Të arrestuarit Marjel Fierza dhe Genti Nderjaku në gjykatë

Sokol Nishani tha se të dy të rinjtë u kapur në makinën në pronësi të Fierzës dhe që drejtohej nga ky i fundit. Prokurori pohoi se në cantat e dy të rinjve u gjetën dy pistoletë gjatë kontrollit të ushtruar nga policia. "Genti Nderjaku nga Shijaku, me banim në plazhin e Durrësit ka tentuar të hedhë cantën marsupial, por kjo është pikasur nga policia në postbllok dhe makina me katër djem, shokë me njëri-tjetrin u dërgua në polici, ku u nënshtrua kon-

trollit. Nga policia jemi vënë në dijeni se Nderjaku ka leje për brenda banesës për mbajtje arme të firmosur nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë. Nuk jemi njohur akoma me shkresat, por as me të kaluarën e tyre. Kërkoj që gjykata të vendosë masë sigurie burg pa afat për Fierzën dhe detyrim paraqitjeje për 34-vjeçarin Nderjaku", tha prokurori Nishani. Nderkaq, mbrojtësit e dy të ndaluarve nuk e kundërshtuan arrestimin në flagrancë, por

parashtruan pretendimet e klientëve të tyre. Avokati mbrojtës i Mariel Fierzës deklaroi se, "klienti im së bashku me të ndaluarin tjetër dhe me dy shokë të tyre kishin drekuar në një lokal buzë detit te shëtitorja 'Taulantia'. Mjetin e kishin par-kuar para disa depozitave të ujit. Kur u kthyen, mbi një depozitë uji gjetën një pistoletë. Marjeli e mori armën dhe ishte nisur ta dorëzonte në polici, por nuk pati kohë ta dorëzonte, sepse e kapi një patrullë policie dhe u arrestua. Arma tip 'Bereta' nuk është e klientit tim". Në fund të seancës gjyqësore, gjykatësi Paulin Cera e konsideroi të ligjshëm arrestimin e Marjel Fierzës, i cili etiketohet si "ushtar" i Lulëzim Berishës, që drejtoi për 10 vjet bandën e Durrësit dhe të shokut të tij, Nderjakut. Ai vendosi lënie në burg të 30-vjeçarit Fierza dhe lirinim nga qelia të Genti Derjakut.


Përplasjet e bandave në Elbasan, Çapjati apel mediave: Mos spekuloni me ne!

ELBASAN - Pas operacioneve të policisë dhe forcave speciale në Elbasan dhe lajmeve të dhëna në media për përplasjet mes bandave në këtë qytet, ku më së shumti është përmendur fisi Çapja, dy anëtarë të këtij fisi kanë reaguar publikisht, duke u distancuar nga akuzat. Ata apeluan që mediat të pasqyrojnë të vërtetën dhe të mos spekulojmë mbi të vërtetën e ngjarjeve. "Të nderuar zonja dhe zotërinj të mediave! Në emër të familjes Ardjan dhe Ermira Çapja dhe të ligjit, ju kërkojmë të mos spekuloni me të vërtetën dhe lajmin. Në të kaluarën familja jonë ka vuajtur nga shtrembërime të së vërtetës. Ka ardhur koha që mediat të marrin përgjegjësinë e së vërtetës. Me respekt, Ardjan dhe Ermira Çapja".



Vranë para një viti 42-vjeçarin, arrestohen 2 vëllezërit Mujeci

LEZHË - Forcat e policisë së Lezhës në bashkëpunim me blutë dhe FNSH-në e Shkodrës dje vunë në pranga 38-vjeçarin Lin Mujeci dhe vëllain e tij 30-vjeçar, Kreshnik Mujeci nga fshati Torovicë. Ata u kapën gjatë operacionit të koduar "One Year", ndërsa akuzohen se në bashkëpunim me vëllain e tyre, Jozef Mujecin kanë vrarë pas një konflikti 42-vjeçarin Genc Mhillaj (Pjetri). Ngjarje kjo e ndodhur më 6 tetor të vitit 2016 në vendin e quajtur Mali i Jushit në Shkodër. Mësohet se dy vëllezërit Mujeci u morën nga shtrati thaujse të zhveshur dhe më pas u dërguan në Shkodër. Sipas policisë, Lin dhe Kreshnik Mujeci akuzohen për veprat penale: "Vrasje me pararendim", kryer në bashkëpunim dhe "Armëmbajtje pa leje".






Mavrovë



Ski në Dëborë

Skijimi në Maqedoni është sport popullor që është i preferuar nga njerëzit lokal si dhe turistë të huaj. Maqedonia ofron kushtet të mira klimatike për sportin. Skijimet alpine dhe nordike janë ngjarje të mëdha që mbahen për të nxitur bukurinë e maleve të Maqedonisë. Ka dy ngjarje tradicionale që organizohen nga punëtorët e skive maqedonase: Turneu memorial i Mavrovës dhe Turneu ndërkombëtar i Skijimit Alpin i njohur edhe si Kupa e Malit Sharr që janë dy ngjarje sportive të njohura në Maqedoni të cilat janë të organizuara nga komuniteti Bistra dhe Popova Shapka. Sportelet e konvikteve të Skijimit në dëborë janë shumë të popullarizuara në Maqedoni. Ju mund të bëni ski në disa vende si: Mavrovo, Mali Sharr, Kozhuf, Pelister dhe Krushevë.



Upload,
download, aty,
këtu, kudo.

E ardhmja
është emocionuese.

Ready?

 **vodafone**

Opinion i Ditës

Kiço Blushi

(Vijon nga faqja e parë)

... e artikulluar në dëgjuesen e Fierit, ka kaluar pa u vlerësuar, pa u analizuar e pa u thelluar, edhe pse frazat e mësipërme shprehin, në mënyrë të sintetizuar, mendësinë e politikëbërjes e të komunikimit me publikun të Ramës dhe, pse jo, edhe të kësaj qeverie në këto katër vjet e tëhu.

Përfundimi i parë, i kapshëm dhe më i drejtpërdrejtë, që vetvetiu del pas lëvizjes së "falënderimit" të singertë të kryeministrit është se ambasadori amerikan nuk doli në mbështetje të qeverisë, por personalisht të Ramës në luftën që ky ka vendosur të zhvillojë në mandatin e dytë kundër kimit të organizuar dhe bandave...Tekefundit kjo do të thotë që Rama, dhe sidomos Ministria e Brendshme e Tahirit (që ka qenë më e suksesshme, më e lëvduara, sipas kryeministrit, edhe nga ndërkombëtarët...) në katër vjetet e Rilindjes, kanë dështuar. Elbasani, dhe jo vetëm ky qytet, qenkan nën kontrollin e familjeve e klaneve kriminale dhe jo të qeverisë së Rilindjes.

Me sa duket, këtë realitet kryeministri e njohu falë zbulimit të papritur që i bëri realitetit të zymtë ambasadori amerikan, e kjo, me gjasë, duhet të na e rilindi shpresën në qytetarëve se Rama, me ndihmesën e LU-së, ka për të kryer mbas sodit një luftë të pashembullit, të vështirë, përfundimtare dhe, pse jo, edhe heroike kundër bandave kriminale dhe "njëzet familjeve mafioze që e kanë qeverisur Shqipërinë"...

Po ku ka qenë kryeministri që flet sikur për katër vjet të ishte në opozitë? Në një vend normal as kryetari i opozitës nuk mund

Si mund të kuptohet "mbështetja" e Lu-së për Ramën



të shprehet politikisht e publikisht me një të tillë gjuhë prej sejmieni kokorrok.

Përfundimi i dytë logjik është se, ashtu si në fushatën zgjedhore, Rama synon të personalizojë edhe luftën kundër kimit të organizuar dhe familjeve mafioze. Ai distancohet përtej tyre. Jo vetëm pse në çdo dalje publike ai përherë flet në vetë të parë (jo me NE, por me UNË!), por, ashtu si ka vepruar edhe në parti, ai i shmang enkas forumet, institucionet, përfshi, në këtë rast, edhe Ministrinë e Brendshme dhe Policinë e Shtetit, të cilët janë ngarkuar me këtë detyrë nga Kushtetuta për të përvetësuar suksesin, jo dështimin.

Duke i dhënë vetes fuqinë dhe meritën e ndryshimit rrënjësor (kryesisht të fasadave), Rama beson se kësajsoj do t'i bishtojë

përgjegjësisë për këtë situatë alarmante në të cilën Shqipëria nuk ka qenë kurrë. Të qenit kryeministër fuqiplotë, nuk e ndihmon dot të përballët me klanet mafioze, si tallët me kazanxhinjtë mediaticë... Në të kundërt ai shprehet se nëpërmjet batutave me "Fb" dhe me TV Ramën jo vetëm që nesër nuk do të fajsohet, por do të memorizohet në histori si burim i vetëm suksesi i "kësaj shoqërie të sëmurë" që i la në trashëgim Berisha dhe Basha.

Por ai nuk e di që vetëm frazat e mësipërme, edhe të mbetura në arkiv, do të mjaftojnë për të vizatuar portretin e tij real si kryeministër. Sepse, në fund të fundit, ato do të provojnë e dëshmojnë impotencën dhe pamundësinë e tij për të ndërthur një shoqëri normale pa krim dhe pa korrupsion, derisa kërkon "mbështetjen" e ambasadorit amerikan, si një vasal pa dinjitet.

Krerët tanë dehen shpejt me veten, verbohen e shurdhohen kollaj, masturbojnë me fjalën e tyre ndaj lëshojnë deklaratatë të kësollojta, të papërgjegjshme, të cilat mund t'i shërbejnë momentit "sa për të kaluar lumin", pa e vrarë mendjen e pa e kuptuar që fjala publike është një armë tejet e rrezikshme, e cila të ndihmon të eliminosh kundërshtarin, por edhe për të kryer vetëvrasje morale, po që se të kthehet kundër, kur bën kundërsiens me çka ke thënë më parë...Krerët tanë

prandaj edhe bëhen autokratë, fillimisht paranojakë e në fund qesharakë, se nuk ia dinë fuqinë hakmarrëse fjalës publike, arkivit dhe kujtesës popullore.

Përfundimi i tretë është se kryeministri indirekt pranon që ambasadori amerikan në Shqipëri ka fituartribute komanduese. Tanimë askush nuk dyshon se fjala e tij është e padiskutueshme si nga qeveria dhe nga opozita. Vini re: kryeministri nuk thotë, si do ta lupte gjuha diplomatike e politike: "në këtë luftë me krimin e organizuar kemi mbështetjen e qeverisë amerikane"... por e personalizon edhe partneritetin me amerikanët, duke iu drejtuar jo pa qëllim ambasadorit personalisht.

Kjo qasje mediaticke synon që në qytetarët e zakonit duhet të bindemi e të besojmë se në Shqipërinë e sotme janë dy njerëz, Rama dhe Lu, që "e mbështesin" njëri-tjetrin dhe që, në duart e në vullnetin e tyre gjendet çelësi i suksesit (ose i dështimit...), i demokracisë, i luftës kundër kimit të organizuar, bandave dhe trafikantëve.

Besoj se, pas këtij arsytimi, natyrshëm lind pyetja retorike: Po sikur; Largoftë! Lu të mos kishte dalë në mbështetje të Ramës, si do të na vente halli në shqiptarëve?

E megjithatë nuk duhet të dëshpërohemi, pasi së shpejti nuk do të kemi nevojë të nxjerrim 24 certifikata nga lagjia...

Se do të hyjmë së shpejti në "një fazë të re"...

Dakord, po pse kësaj here kryeministri nuk e përmendi fjalën "rilindje", po artikuloi frazën "fazë e re"? Mos vallë edhe ai e ka kuptuar se Rilindja u bë për krye shëndoshë, edhe pse "tepsinë" Rama e ka për vetë? A thua kryeministri përnjëmend dëshiron të ndajë timonin me ambasadorin amerikan, si e vetmja alibi që mund ta shpëtojë nesër nga ndëshkimi, nëse në fund të vitit nuk do të zhdrukë kanabisin, (si ka premtuar), dhe nëse në pranverën e ardhshme nuk do të zhdrukë katër klanet e njëzet familjet mafioze?

Baba, e kapa hajdutim! Lëshoje, bir!, - i tha i ati... Unë e lëshoj, po nuk më lëshon mua ai...



Implemented by giz

Programme: Climate Friendly Integrated Waste and Recycling Management

The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) is a federal enterprise that supports the German Government in achieving its objectives in the field of international cooperation for sustainable development. The program CFIWM assists Albania to provide affordable and ecological services in the field of solid waste to its population with an orientation at EU standards. In particular support is planned to the following four areas:

1. implementation and further development of the Integrated Solid Waste Management strategy
2. establishment of waste separation and composting
3. increase of recycling and reduction of solid waste
4. effective sector regulation and monitoring

GIZ supports, in particular, the modernization of the solid waste management system in the Municipalities of Peqin and Rrogozhina. To strengthen our local capacities in Peqin and Rrogozhina,

GIZ Office Albania seeks the following staff:

Advisor to support the Municipalities of Peqin and Rrogozhina with the implementation of their Solid Waste Management Plans

At average, the advisor will work ¾ of her/his working time located in Peqin or Rrogozhina and ¼ from the project office in Tirana.

A. Responsibilities

- Advisor to the Municipalities of Peqin and Rrogozhina, private and NGO stakeholders as well as the general public on the implementation of the new solid waste management plans (waste management technology, processes, management including financing and fees, monitoring and evaluation, documentation). The modernisation will focus on the introduction of solid waste separation at the source, increasing recycling, and treatment of organic waste.
- being the project's focal person for (a) cooperation with the private sector as well as (b) human resource development for municipal staff
- supporting the project manager with project steering
- innovation and knowledge management

The technical solid waste management expert performs the following tasks:

B. Tasks

1. Professional Advising and Consulting

- Supervises development and implementation of project plans and activities in close coordination with counter partners within the Municipalities of Peqin and Rrogozhina
- Contributes to preparation and implementation of the consultation process, the project's activities, and efforts in the Municipalities of Peqin and Rrogozhina
- Assists in defining terms of reference, selection, and supervision of contracted third parties in carrying out project's activities, including educational campaigns Municipalities of Peqin and Rrogozhina
- Conceptualises, prepares and implements workshops, seminars, and other events on subjects that are related to the project's field of activities within the Municipalities of Peqin and Rrogozhina
- Advises partners and project colleagues as the project's focal person for municipal administration and service provision in particular in the field of solid waste management

2. Communication and networking

- Co-operates with and ensures regular contacts, dialogues: does PR work and cooperates with rele-

vant organizations, international development partners, non-governmental bodies and persons within the program's project's environment as well as with other projects in order to enhance and maintain good working relationships

- Communicates and channels local interests and aspirations and exchanges ideas and information for the benefit of the programme

3. Knowledge management

- Assist in improving the project's knowledge management system and tapping into other knowledge management systems;
- Compiles information about ongoing programme activities and ensures knowledge transfer
- Develops strategies and technical concepts including guidelines, manuals, and procedures, which are ready to be applied
- Prepares reports and presentation materials

4. Management and Coordination tasks

- Contributes to project planning/develops project designs, including preparation, organization and moderation of planning exercises, implementation, management, monitoring, quality management, evaluation, communication, and documentation in regard to municipal services, cooperation with the private sector and human resource development
- Coordinates and prioritises relevant project activities in cooperation with the partners, as well as in organizational preparation and in the implementation of these activities within the Municipalities of Peqin and Rrogozhina
- Prepare the budget for project events within the Municipalities of Peqin and Rrogozhina

C. Required qualifications, competences and experience:

- masters or bachelor degree relevant to municipal or public service or in environmental/engineering sciences or extended professional working experience in or with the Albanian municipal or public service
- at least 5 years of work experience in a relevant area
- experience in municipal or public service provision or extensive work experience inside or with development partners
- Ability to support a multi-task, multi-discipline project team
- Fluency in written and spoken Albanian and at least a fair command of the English language; command of German language would be an additional asset
- Able to work in a team as well as independently
- High level of reliability
- A personality with excellent social and communication skills
- Clean driving licence for cars being a very reliable driver

Contract conditions:

- Full-time employment
- Project offices in Peqin or Rrogozhina and Tirana
- Assignment period: 01.11.2017 until 31.08.2019

Please forward your application until 19.10.2017 to GIZ Office Albania by E-Mail: giz-albanien-hr@giz.de including the following information: Application letter, CV in English (Europass format), references. Only short-listed candidates will be contacted for interviews. Short-listed candidates will be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates.

GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!



BLUE TOOTH

Thashetheme
MADE IN ALBANIA

Nr. 579

SUPLEMENT I PERJAVSHEM

GAZETA SHOIPTARE

Redaktore: Enida Hlmaj - Art Designer: Nevila Samarxhi

E shtune 7 Tetor 2017

MAMAJA E TE FEJUARIT të moderatores, kryetarja e re e "Aleanca Kugezi"



Ja si janë
marrëdhëniet
e Floriana
Garos me
vjehrrën e saj

KUSH ËSHTË LUMTURI
RATKOCERI DHE
HISTORIA NE
POLITIKE



INCIDENTI "HOT" Luana, nxjerr "zogun" në "Instagram"



E ZBULON GAZETARJA,
"ZAJMINA ËSHTË NË
MUAJIN E 6 TË
SHTATZËNISË"



Anaidi flet për ish-të dashurën, Oriola Marashi

"I uroj gjithë të mirat në këtë jetë"

Ish-fituesi i "Big Brother", Anaid Kaloti ka folur edhe njëherë për jetën e tij dhe për famën pas reality-show. I ftuar në emisionin "Pasdite në Top Channel", ku u pyet për lidhjen me modelen, Kaloti u shpreh gati i irrituar: "S' dua ta komentoj këtë pjesë! Nuk kemi pse të flasim më për njëri-tjetrin për sa kohë nuk jemi afër". I pyetur nëse shkak për këtë është ndoshta shija e hidhur që kjo ndarje i ka lënë, Anaidi u shpreh: "Nuk ka lidhje se shijet janë personale, varet si e percepton gjithsecush kur largohet. Normalisht i uroj suksese dhe gjithë të mirat në jetë". Oriola dhe Anaidi janë ndarë thujse një vit më parë dhe që prej asaj dite asnjëri prej tyre nuk foli për raportin që zgjati thujse 4 vjet.



Fjolla Morina heq dorë nga muzika


Këngëtarja gati për t'i hyrë rrugës së biznesit

Fjolla Morina është njëra ndër këngëtares që më së shumti komentohet nëpër

media. Përveç muzikës, ajo është përfolur edhe për jetën e saj private. Këngëtarja me linjat seksi së fundmi në një intervistë për mediat në Kosovë, ka thënë se së shpejti do ta lë muzikën. Në intervistë seks-simboli Kosovar shprehet se në një të ardhme do heqë dorë nga karriera në muzikë, pasi do t'i përkushtohet një biznesi që ka ndërmend të hapë.

Rita Ora ngre këmbët dhe tregon pjesët intime gjatë xhirimit të klipit të ri

Këngëtarja shqiptare me famë ndërkombëtare, Rita Ora ka nisur xhirimet e klipit për këngën e saj më të re. Disa nga skenat janë xhiruar rrugëve të New Yorkut. Bukuroshja shqiptare ka tërhequr mjaft vëmendjen e kalimtarëve, falë veshjeve të saj, të cilat i ka ndërruar disa herë. Mirëpo, në njërin prej veshjeve, ajo është "tradhtuar" paksa. Në një moment, Rita teksa ngre këmbët, thujse tregon shumë nga pjesët intime. Sigurisht këto poza nuk kanë mundur t'u shpëtojnë paparacëve, e më pas mediave rozë.





Sipas këndvështrimit tënd

E ardhmja
është emocionuese.

Ready?

 **vodafone**



Xhesika Ndoj numëron eurot “Punë është edhe kjo”

Xhesika Ndoj është një nga vajzat më të diskutuara të showbizit. Ajo u bë pjesë e muzikës duke nxjerrë në treg videoklipe me përmbajtje përgjithësisht erotike, që duket se tërhoqën mjaftueshëm vëmendjen e publikut, kryesisht të rinjve. Ndoj gjithmonë edhe në rrjetet sociale shquhet për fotografitë provokuese dhe fotot me armë apo para. Mirëpo me postimin e bërë së fundmi, ajo i ka lënë gojëhapur të gjithë ndjekësit e saj. Xhesika ka postuar në profilin e saj në “Instagram”, një foto ku bien në sy sasi të mëdha me euro. Fotoja mban këtë mbishkrim: “Punë është edhe kjo”. Kjo pasi shihet se ajo po i numëron, dhe me sa duket Xhesika paska fitime të shumta.



Adelina Tahiri kapet duke blerë rroba të lira

Ajo është një nga këngëtaret që më së shumti e reklamon jetën e saj luksoze dhe blerjet e rrobave firmë. Por duket se Adelina Tahiri nuk bën përjashtim nga vajzat e tjera, dhe zgjedh që të blejë edhe rroba të lira. Në një foto të publikuar nga “Vipat e Bllokut”, këngëtarja shihet teksa sheh disa bluza, të cilat kushtojnë 8 euro. Ndërkohë në postimin në “Instagram”, shkruhet: Adelina Tahiri, para disa në emision muajsh the qe harxhon shopping 150 mijë euro në muaj. Me bluzë 8 euro? Apo i ke fake hublot dhe Guccit që vesh”.



Enca tregon se të paktën këtë gjë e ka natyrale

Asaj i pëlqen shumë të eksperimentojë me ngjyrën e flokëve, po dhe me gjatësinë e tyre. Bëhet fjalë për Encën. Flokët e saj janë mjaft të veçantë, fakt ky që i bën shumicën e vajzave xhelozje. Flokët e gjatë dhe të shëndetshëm të bukuroshes nuk mund të mos bëjnë bujë edhe kur Enca ndan me ndjekësit e saj në rrjetet sociale foto. Pak ditë më parë bukuroshja ka publikuar në llogarinë e saj në “Instagram” disa foto, të cilat na habitën pasi papritur ajo u shfaq me flokë të shkurtër dhe biondë. Sapo ka bërë këtë ndryshim, këngëtarja nuk ka nguruar që të postojë foto të tjera me flokët e reja, por e gjitha ka qenë një gënjeshtër, pasi Enca vazhdon t'i ketë ende flokët e saj shumë të gjatë, të derdhur, të plotë e të palyer. Këngëtarja ka postuar në “Instastory” foto të tjera ku tregon gjatësinë reale të tyre kur sapo ka dalë nga dushi.



Incidenti "hot" i Luanës, nxjerr "zogun" në "Instagram"

Ajo njihet për postimet e shumta tepër ndjellëse dhe tërheqëse në rrjetet sociale. Edhe pse ajo që tërhoqi më tepër vëmendjen këtë vjeshtë ishte fakti se nuk mundi të ndahej edhe me rastin e martesës nga motra e saj e madhe, Marina. Po flasim pikërisht për bukurshen bombastike Luana Vjollca, e cila po shijon pushimet në Xhamajka së bashku me partnerin e saj Krenarin dhe çiftin e sapomartuar Marina dhe Get Selimi. Kjo u vërtetua fare thjeshtë nga fotot e postuara në rrjetet sociale të moderatores seksi, të cilat tregojnë se vendodhja e saj ishte në Xhamajka. Nuk kemi pse e vëmë në pikëpyetje në është vetëm apo larg çiftit, sepse kjo vetëkuptohet. Por gjithsesi nuk




kanë munguar as fotot superseksi të Luanës ku tregoheshin linjat e saj bombastike dhe tepër joshëse. E veshur me një palë bikini të verdha fotoja nuk i lë shumë vend fantazisë. Duket se edhe pse "xheloz" partneri i saj, ajo nuk heziton të postojë edhe foto të tilla provokuese. Nuk kemi se si të mos shohim se në bikini e veshur duket pakëz një pjesë e "zogut" ku Luana edhe pse pa mendje, mundohet ta fshehtë.

Ndërsa në një foto tjetër të postuar ajo del nga ujerat e ujëvarës së parajsës xhamajkane prapa saj me një palë bikini të kuqe ku duket si një sirenë e vërtetë. Këto dhe foto të tjera të postuara në "Instagram", nuk kanë se si të mos i kënaqin ndjekësit e saj të cilët janë të shumtë. Këto pushime do të jenë të paharrueshme për moderatoren e "E diell", e cila nuk ka se si të mos i shijojë ato në praninë e dashurisë së saj më të madhe, Marinës dhe pse jo dashurisë së saj të zemrës, Krenarit. Edhe pas thashethemeve të nxjerra në prapakuina (ku ka zë s'është pa gjë, gjithsesi) të mosmarrëveshjes mes Getit dhe Krenarit, duket se ky udhëtim u bë



shkaku dhe mbase edhe arsyeja e shuarjes së këtij "konflikti" duke i vënë qershinë mbi tortë dasmës me një udhëtim të katërt çift. Nuk kanë qenë të shumta fotot e postuara nga ky vend ekzotik, por ajo që është e sigurtë është se nuk kanë se si të mos kalojnë një "muaj mjalti" më se të ëmbël, në parajsën e egër të Xhamajkës.



Ridel historia e birësimit të Blendi Fevziut. Ja cilët ishin prindërit e gazetarit



Blendi Fevziu është tashmë i njohur për publikun shqiptar dhe më gjerë në krye të emisionit shumë të ndjekur "Opinion". Disa ditë më parë ai festoi ditëlindjen e dytë të së bijës, ndërsa prej vitësh është bërë prind me vajzën e madhe, Mishel. Mirëpo, e keni ditur se vetë Blendi është fëmijë i birësuar? Madje, as mbiemri i tij i parë nuk ka qenë Fevziu, por Bregasi. Ai ka lindur në fshatin Çermë të Lushnjës nga prindërit biologjikë Hektor dhe Rezane Bregasi. Ka qenë Ali Fevziu ai që e ka birësuar Blendin në një moshë të brishtë. Në vitin 1983, kur Fevziu mbushi 14 vjeç, me vendim të Gjykatës së Tiranës, e ndryshoi mbiemrin nga "Bregasi" në "Fevziu" për shkak se ishte birësuar pranë familjes së Ali Fevziut. Ali Fevziu, sipas vendimeve të gjykatës, ishte djali i Niagjar Toptanit, vajzës së Refik Bej Toptanit dhe kjo shpjegon edhe lidhjen e Fevziut me Toptanajt, familjen e vjetër tiranase dhe pronat e tyre.



Mamaja e të fejuarit të moderatores, kryetarja e re e “Aleanca Kuqezi”

Ja si janë marrëdhëniet e Floriana Garos me vjehrrën e saj

Kush është Lumturi Ratkoceri dhe historia në politikë



Të shumë ishin ata që u habitën kur dëgjuan për lidhjen e re të Floriana Garos dhe Enis Dacit dhe u bënë kuriozë për të njohur edhe më shumë djalosin simpatik, që i kishte rrëmbyer zemrën bukuroshes shqiptare. Prezantuesja këtë sezon nuk u shfaq më në ekran, e as nuk jeton më në Shqipëri. Ajo ka nisur një jetë të re në krah të fejuarit të saj, avokatit Enis Daci, i cili ka një karrierë të suksesshme në Zvicër. Ata kanë nisur atje bashkëjetesën, ndërsa Floriana në intervistën e fundit për programin “Lart e Poshtë” në TVSH, u shpreh se ka nisur aktivitetin e saj të përditshëm, duke u angazhuar me punë dhe kurse për mësimin e gjuhës. Ndërsa

sa i takon të fejuarit, Floriana ka thënë shumë pak e në fakt djaloshi në fjalë duket se i qëndron larg ekspozimit në publik. Por duket se krejt ndryshe është mamaja e avokatit simpatik. Vjehrra e Florianës është Lumturi Ratkoceri, kryetarja e re e Aleancës Kuqezi, pas dorëheqjes së Kreshnik Spahiut. Zonja është vendosur në Zvicër në vitin 1991 ku ka rritur edhe dy djemtë e saj, Enis-in 32 vjeç dhe djalin e vogël 21-vjeçar që është ende student, por duket se Lumturia është mjaft e angazhuar edhe me politikën shqiptare. Shpesh herë në rrjetet sociale, si një zë opozitar, ajo nuk harron pa sulmuar qeverinë, apo edhe politikanët e mazhorancës. Në rrjetet e saj sociale, vjehrra e Florianës ka foto edhe përgjatë fushatës elektorale. Por ajo që bie në sy është se Lumturia nuk ka foto me familjen e saj, apo me nusen. Me aq sa kemi mundur të mësojmë, Floriana ka një marrëdhënie të mirë me vjehrrën e saj. Miqtë pranë prezantueses rrëfejnë se të dyja kanë një raport miqësor, duke e konsideruar njëra-tjetrën edhe si dy mikeshja. Duket se jeta e Florianës ka ndryshuar totalisht që pas lidhjes së saj me Enesin, e tashmë që bukuroshja është nuse në shtëpi e Lumturies, raporti saj i mirë me vjehrrën, duke se është një tjetër lajm i mirë që na vjen nga Zvicra.



E zbulon gazetarja

“Zajmina është në muajin e 6 të shtatzënisë

Që pas verës, kur postoi foto të shumta ku shfaqej hot, Zajmina nuk u shfaq më në rrjetet sociale, duke lënë mister edhe të vërtetën e shtatzënisë së saj. Deri më tani askush nuk e dinte sesi po ecte shtatzënia e këngëtares, apo edhe sa kohë i duhej për të sjellë në jetën fëmijën e saj të parë. Por ditën e sotme, gazetarja Elona Duro deklaroi gjatë emisionit të saj se Zajmina është në muajin e gjashtë të shtatzënisë. Këtë ajo e bëri në emisionin “Pop Culture”, ku aksidentalisht u shpreh: “Edhe Zajmina është në muajin e 6-të apo jo?”. Mesa duket bukuroshes seksi i kanë mbetur edhe tre muaj përpara se të marrë në krah fëmijën e saj të parë.



Opinion *i* Ditës

Mësuesi, jo vetëm i portaleve dhe skupeve televizive

Nga Andon Andoni

(Vijon nga faja e parë)

...famshëm një njeri të zakonshëm, nxirre në televizor dhe thuat që ai ka kafshuar një qen, më përsëriste shpesh, shkrimtari Vath Koreshi, e nëse do ta futësh në fund të dheut, përsëri nxirre në televizor".

Mu kujtua miku im Vath, tekta po ndija një nga formatet investigativ të tipit "Stop", "Fiks fare" "Boom" të Ora News këto ditët e fundit. Flitej për mësues, nxënës, shkolla, drejtori shkollash etj. Normale në këtë fillimviti. Por nëse i ndjek këto emisione, në raport me fushat e tjera të jetës shoqërore, më duket se pak si tepër po i bihet në qafë arsimit. Dhe për më shumë jo gjithmonë me të drejtë.

Për hir të së vërtetës ka dhe gjen dinjitet, shpresë, motivim në shumë prej denoncimeve të emisioneve investigative në formatet e përmendur më sipër, në televizioneve shqiptare. Luajtur në një fushë, ku askush nuk ka guxuar, ato i kanë dhënë publikut të gjerë, fakte dhe realitete tronditëse, të atyre që kanë dëshur të shkojnë kundër rrymës së ligjit, rregullit dhe shtetit. Drejtësia, (sipas medias vetë) është vënë në vend përmes këtyre zbulimeve apo thënë më ndryshe, vetëm pas bërjes publike prej tyre! Kjo e "shkuarjes së hakut tek i zoti", është një çështje, që ngre debat, pasi jo gjithmonë kjo "e drejtë" ka qenë e përputhur domosdoshmërisht me akuzën denoncuese të ekranit dhe shtypit. Që kjo fuqi e medias, siç shkruate botuese i gazetës "Telegraf" më 1928, Koste Çekrezi, "të bën që të varesh në litar apo, të të heqë hallkën e tij nga fyti", është e njohur.

Pikërisht, të denoncime të tilla e kanë pasur fillësen, zbulimi dhe prangosja e plot elementeve që kanë shkelur ligjet e këtij vendi. Ngjarje të bujshme, dhe publiku prej me të kërshëri atë "Nesër avazi, nesër".

Por ajo që dua të ndaj me lexuesit në këto radhë është paksa më komplekse. Çfarë ju intereson më shumë këtyre lloj formateve televizive? Zbulimi i skandalit dhe korja e dafinave, vënia në vend e drejtësisë apo rendja pas një audience sa më të madhe?!

Sigurisht, që të tria janë të rëndësishme për një televizion serioz dhe gazetari serioze, por nisur nga syri i një profesionalisti, në njëriën nga këto tri kolona, kandidati anon më shumë nga audienca! Duket se tek të tri formatet e përmendura, tekësi vihet të shkueshmëria dhe publiku. Emisionit i bëhet hzymeti vetëm prej këtë të fundit, audiençës dhe përfitimim e reklamave të lidhura me të. Dikush do pohojë se kjo është normale.

Pol! As një gjë të keqe nuk ka, por kur rendet vetëm pas sigurimit të saj, duke kërkur me lupë "viktima" të paqena dhe të vetësuajuara, kjo e demton audiençën. Përdorimi i rastit, i "konservuar"



për muaj me radhë, dhe servira e tij "me plan" si pas të vjeli rrush, është një tullumbace e shkrehur dhe nuk i shërben vetë çështjes. Ballafaqimet e palëve përpara kamerave (të fshehura sigurisht) nuk janë gjithmonë shteruese për të vërtetat që duhet të dijë publiku. Ndjato mbulohe me gjoja humor frazash nga drejtuesit e tyre në studio, me sarkazëm, ironi dhe lojë qesëndisëse të balerinëve, balerinave.

Këto emisione, në formatin e Fiksit, Stopit dhe Boomit, kur mungon thuajse krejtësisht gazetaria investigative, përpigjen të fitojnë vëmendjen publike përmes problemeve të një individit, në shumicën e rasteve, në përballje të fortë me institucionet, me organizata apo edhe instanca të qeverive lokale e qendrore. Si në përralla, ndodh që i miri dhe i keqi të përplasen në këtë duel padrejtësisht dhe ku fiton gjithnjë "i dëmtuari" nga pushteti dhe shteti! Në fund, kurorat e dafinës patjetër që i takojnë... emisionit, i cili falënderon, më së fundi "pushtetin" që e zgjidhi konfliktin kokë ulur.

Kjo është formula në të gjithë thellësinë e gjerësinë e lajmeve skupë të këtyre formateve. A sjellin një impakt të dukshëm pozitiv për shoqërinë? Gjersa shoqëria njihet me "këta maskarenj" që dalin kundër rrymës dhe ligjit, po!

Veç, ndonjëherë bashkë me të thatin digjet edhe i njomi.

Le të nisem, sa për ilustrim nga një shembull. Hera- herës këto emisione janë adresuar të shkollat dhe problematikat që kanë ato. Por "të bësh me hije" komunitetin e gjerë të arsimitarëve dhe drejtuesve të arsimit, se mos filmon dikush me kamera a telefona dhe i nxjerrin në TV, nuk është gjasja e duhur. Se nuk i paskësh ardhur radha Ylberit të kapërcëjë nga i

nënti tek i shtati në Portalin e Mësuesit, kjo nuk është ndonjë gjë për të vënë kujën televizive. Të luash me rojën e shkollës "Kongresi i Manastirit", e hoqi a s'e hoqi drejtoresha, dhe në ditën tjetër ai del krahu drejtoreshës, janë mëkate a truke televizive që nuk shkojnë pa lënë gjurmë tek grupet e interesit. Askush nuk më thotë dot se ç'është ky Ylberi? Pse "u përkëdhel" kaq mjeshhtërisht nga media. A është ai një mësues për së mbari? A e ndoqi kush aty ku është dhe të merre opinionin e atyre që e rrethojnë e më të cilët ka punuar ndër vite? Askush. A e dinë mediet që ai dhe shumë prej shokëve të tij, rinë me kamerën e telefonit ndezur kudo që shkojnë?

Në fund të viteve 80, kur punoja si mësues në një zonë të thellë të Librazhdit, mbaj mend një nga figurat më djallëzore të atij komuniteti, E. Roçi, i pashkollë, me ca çizme llastiku dimër e behar, i shkurtër e me ca sy lavrakë, djallëzish të shndritshëm, që dinte të bënte vetëm një gjë në jetën e tij: Të shkruante letra për udhëheqjen e partisë dhe të pushteti dhe mbante xhepat mbushur me citatat e Enver Hoxhës që priste nga gazetaret!?

Ishim 18 mësues që terrorizoheshim prej tij. "Sot kam ditën e shkollës" deklaronte i ligu E. Roçi dhe me mbeteshim zemërngirë kur të vinin inspektorët e Komitetit dhe "Gazi 51" që qëndronte në oborrin e shkollës. Por qëllonte që ky "Gaz 51"-sh, të ndalonte edhe përpara zryave të kooperativës, te qendra mjekësore, te brigada e gjashtë, të stallat e legjorivës. Produkte të të famshmit E. Roçi.

Është bërë modë, që të vrapohet tejte me ngut dhe shpejt, për të fshikulluar aksh mësuesi si pedofil dhe ypsilon drejtues shkolle si dhunues të fëmijëve, etj. etj., Vite

me parë, një drejtor shkolle në Librazhd u "sulmua" moralisht nga një kryetar komune me porosi të partisë. Një mësues në Berat humbi familjen pas thashethemeve të sajura. Ngjarjet bëjnë bujë. Zënë kreun e portaleve dhe faqeve të para të gazetave, Çudia zgjat tri ditë, dhe pas tri ditësh, kur ujtat kthellohen dhe e drejta, (sipas proceseve në gjykata) ka kaluar në favor të mësuesve të akuzuar, asnjë medie, asnjë emision përfshirë edhe këta të skuptit, nuk ka thënë asnjë fjalë për "lajmin e bujshëm që zgjati tri ditë". Ka pasur familje që janë prisurur

dhe individë që kanë pësuar trauma të vërtet pas revansheve të hidhura mediatake, por askush nuk është kujtuar për ta. Për dëmin moral, psikologjik që iu ka shkaktuar. Media jo se jo. E ka mbyllur njëherë e mirë gojën dhe e ka hedhur pas krahëve mësuesin "dhunues", "pedofil" dhe drejtoreshën "gjuhë gjatë".

Nuk kam asnjë motiv për të mbrojtur sjellje dhe arroganca të rrjedhura prej pushtetit, qoftë edhe të vetë një drejtori shkolle a mësuesi, por nuk duhet të harrojmë se me këtë gjasje të tillë rojvansi ndaj figurës së shenjtë të mësuesit, ka vite që ai, jo vetëm nuk po gjen mbështetje prej shoqërisë, por përkundrazi, në bllok, po denigrohet, fyhet duke i dhënë dorë dhe krahë, individëve të tallen me të në orën e mësim, prindërve të nxjerrin gjoksin dhe ta kërcënojnë për "nota të pamerituara" dhe vetë shtetit, që për të mbrojtur gjoja, në emër të lirisë dhe të drejtave të njeriut, "urdhërojnë" që të mbahen me çdo kusht brenda shkollës, edhe ata, që nuk janë për shkollë, brenda klasës, edhe ata, që hyjnë nga dritarja serbeses dhe dalin nga dera kur t'u teket dhe të kalojnë pa mbetje, edhe ata që nuk ka shansë t'i kalojë as Perëndia. Mësuesi, i vënë në darën e egër të asaj që duhet bërë dhe nuk duhet bërë, ka mbetur në pritje. Vetë organizmat e shtetit dhe pastaj mbarë shoqëria duhet të kthejnë sytë me urgjencë për të gjetur udhë të reja për rimëkëmbjen e dinjitetit të arsimitarëve. Duke vlerësuar drejt sakrificat e mëdha që ata bëjnë për të edukuar rininë e sotme jo pak të vështirë, dhe përpjekjet e mëdha të tyre për të kapur kohën e teknologjisë, për të implementuar reformat e reja të shkollës dhe për të shtyrë në hulli të reja edukimin.

HOROSKOPI

DASHI

Mos u hidhni shumë përpjetë, nëse nuk doni të rrezikoni të rrezoheni! Duhet të qëndroni me këmbë në tokë dhe të mos përfshiheni nga aventura tepër të rrezikshme. Mendoni për pasojat e veprimeve që kryeni, do të shmangnit rrezikun për ta pësuar.

DEMI

Nëse po shqyrtoni mundësinë për një udhëtim, për argëtim apo për punë, mos u ktheni mbrrapa. Parashikohen përvoja shumë interesante në vijim! Mund të pasuroini bagazhin tuaj kulturor me njohje dhe njohuri të reja. Me të vërtete shumë mirë.

BINJAKET

Nëse në të kaluarën keni marrë një ndihmë të papritur, tani është koha ta ktheni favorin pa u tërhequr mbrrapsh. Në fund edhe ju do të shpërbleheni. E rëndësishme është t'ia nisni mbarë, nganjëherë gatishmëria vlen, në disa raste, më shumë se çdo gjë tjetër.

GAFORJA

Kujdes nga kokëfortësia, sepse mund të sjellë gjëra të pakëndshme. Më mirë të udhëhiqeni nga dikuj që ka më shumë përvojë sesa ju. Përvoja ju mëson, por nëse nuk jeni të sigurt për diçka njëqind për qind, nuk duhet as ta provoni.

LUANI

Ata që varen nga ju nuk bëjnë punën e tyre, astu siç prisni, qortojni, sigurisht, por pa e bërë të madhe. Nuk keni arsye perse ta bëni. Më mirë thojni gjërë siç janë, pa shumë lojë fjalësh, në mënyrë të qartë, të drejtpërdrejtë dhe të saktë.

VIRGJERESHA

Sot do të vini në jetë ide nismëtare. Jeni të patodhshëm, të aftë për të punuar pa ndaluar. Nganjëherë, megjithatë, nuk e kuptoni që e tejkalojnë masën. Një ofertë pune duket shumë premtuese. Çfarë prisni për ta pranuar? Mos humbi kohë!

PESHORJA

Keni të bëni me çështje të brendshme dhe familjare të pazgjithura, dhe mund ta shfaqni më shumë sesa duhet nervozizim. Përqini ndërkaq të jeni i mirë kooperuesim. Mund të gjeni gjithmonë një pikë të përbashkët dhe të arrini kështu në një kompromis më të gjatë.

AKREPI

Shfrytëzoni favorizim që planetët kanë për të zmadhuar dhuntitë tuaja dhe të përdorni çdo mënyrë për të vënë në vijë punë e juaja. Nganjëherë nuk duhet të lodhni shumë për të rënë në sy, mjafton të zgjidhni me kujdes mundësinë më të mirë.

SHIGJETARI

Një ditë pa shumë bujë. Nëse mendoni se meriteni më shumë, nuk keni bërë llogaritë me ata, të cilët duhet të ndani meritat. Në fund do të dini si ta menaxhoni situatën, pasi nuk doni që të dilni keq.

BRICJAPI

Planetët do të bëjnë që sot të ndiheni më materialistë se zakonisht. Por fatmirësisht pozicionin i Uranit do t'ju ndihmojë që të cilroni fantazinë. Ndosta zgjedhja që do të bëni nuk është ajo që do të pritje nga ju, po përdorni imagjinatën.

UJORI

Dilni nga kllapia dhe veproni menjëherë, nëse nuk doni që të ngeli mbrrapa. Gjë që nuk është kushedi se clarë, zakonisht. Për të gjetur çelësin e problemit, nevojitet që të keni qetësinë e durim mendore dhe të mos shpejtoni.

PESHQIT

Ndryshime të shpejta dhe pozitive, falë bashkëveprimi Diellit me Hënën që ju favorizojnë. Në vazhdim e vendimeve të marra, popullariteti juaj do të pësojë një rritje! Pak krijimtari dhe fantazi në profesion do t'ju sjellë vlerësimin e një eprore.



Katër trofetë e "axurrëve" në teatrin "Migjeni"

Italia ekspozon titujt e saj botërorë në Shkodër

Katër trofetë e fituar nga Italia në kampionatet botërore ndodhen tashmë në qytetin e Shkodrës, ku do të luhet edhe ndeshja e fundit eliminatorie me ekipin fqinj. Me nismën e ambasadës italiane, Bashkisë Shkodër dhe FSHF-së

është hapur ekspozita "4 herë Kampionë" në teatrin "Migjeni". Kjo ekspozitë do të jetë e hapur deri më 9 tetor, ditën e ndeshjes me Italinë. Nisma në fjalë, e parashikuar me rastin e ndeshjes Shqipëri-Itali, e vlefshme për kualifikimet

europiane në fazën finale të Kupës së Botës FIFA 2018, synon të vërë theksin e të vlerësojë ndeshjen e parë zyrtare në historinë e Kombëtares italiane të futbollit në Shqipëri, në këndvështrimin e afirmimit të vlerave pozitive të sportit si dhe të

promovojë më tej miqësinë dhe marrëdhëniet në fushën e sportit ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë. Ata tifoze të "axurrëve", që kanë dëshirë të shohin nga afër trofetë e fituar nga Italia ndër vite, mund ta bëjnë këtë gjë pa pagesë. Ndërkohë, për ata që duan të kontribuojnë financiarisht, duhet thënë se shuma e mbledhur do të shkojë për personat në nevojë.

Panuçi habit me formacionin. Balliu dhe Memolla titullarë, iberikët përfitojnë

Spanja argëtohet, na mund për 11 minuta

Rodrigo, Isko dhe Tiago, autorët e golave



Jeton Selimi

Shqipëria nuk e përballoi dot 'ortekun' spanjoll, me iberikët që shënojnë 3 gola në 11 minuta duke blinduar vendin e parë, ndërsa kuqezinjët vuajtën shumë startin e llahtarshëm të vendësve. Trajneri Panuçi habit me formacionin titullar, ndërsa rreshton nga minuta e parë debutuesi Ivan Balliu dhe Hysen Memolla, me këtë të fundit që i merr vendin në formacion kapitenit Ansi Agolli. Është Etrit Berisha kapiteni i ndeshjes, por e inauguron me minuta stresi ndaj kampionëve spanjollë, ndërsa në sulm dyshja Lullaku-Grezda bën që të ulet në stol Armando Sadiku. Që në minutat e para kuptohet që do të jetë një mbremje e vuajtur për Shqipërinë. Në minutën e 16-të Rodrigo do të çelë rezultatin, duke përfutur nga rreshtimi i keq në mbrojtje. 7 minuta më pas është Isko që dyfishon, ndërsa në të 27-tën Tiago Alkantara. Mbyllet aty pjesa e parë dhe ndeshja e Memollës

dhe Balliut me Sadikun e Agollin, që nisin në vend të tyre pjesën e dytë. Fillimi i saj është i ngjashëm me të parën, me Etrit Berishën që i duhet të tejkalojë vetveten të mos thellohet hendeku në rezultat, ndërsa i mohon golin Koke dhe më pas Rodrigos, që nuk arrin të fitojë duelin me të në të 53'. Pastaj Spanja humbet ritmin dhe janë minutat e Shqipërisë, që luan vërtet mirë me Grezden, madje që preten-



don një 11-metërs për prekje të topit me dorë nga Jordi Alba. Në të 59' Arlind Ajeti nuk gjen goditjen e duhur me kokë në një këndore të Kacës. Pique lë fushën për Saul me duartrokitjet e atyre që e mbështesin, që mbulojnë edhe vërsëllimat e Shqipërisë në të 69' ndalet sërisht te shtylla, që këtë herë e godet Armando Sadiku me kokë. Megjithatë, më e bukura vjen pak më vonë në të 73', kur Latifi i futur nga stoli, merr një pasim nga Lullaku dhe tenton golin, arrin të grushtojë De Gea dhe më pas Sadiku nuk arrin ta kthejë drejt rrjetës. Megjithatë, duhet kuptuar se janë gërvishjet që Spanja mund t'i tolerojë, pasi edhe kur Saul nuk arrin të gjuajë siç duhet, Lopetegui duartroket sërisht. Spanja nuk e gjen dot golin e katërt, por as Shqipëria atë të flamurit dhe mbyllet 3-0 me iberikët që i gëzojnë kualifikimit në Botëror, ndërsa kuqezinjët shtërrojnë dhembët për të bërë më tepër ndaj Italisë.

TRAJNERI I KOMBËTARES

Panuçi: Dhuruar dy gola, patëm 5 raste

Pësuar golin e parë, i cili ishte spektakolar. Dy të tjerët më pas i dhuruar ne. Për fatin tonë të keq bëmë disa gabime dhe i dhuruar dy gola. Sa i përket debutimit si titullar të Balliut, kjo ndodhi sepse nuk kisha lojtarë tjetër. Pse humbëm ndeshjen aq shpejt? Sepse nuk është çështja te sistemi i lojës, por tek mundësitë tona dhe tek disa gabime që bëmë. Në pjesën e dytë ndryshuam disa gjëra dhe luajtëm më mirë. Madje, krijuam edhe pesë raste për gol, por diferenca janë të mëdha. A duhet të ishte formacioni i pjesës së dytë që në fillim? U përpoqëm që të bënim më të mirën dhe ndryshuam diçka", deklaroi trajneri pas ndeshjes në RTSH.

MESFUSHORI I OSIJEKUT

Grezda: I dhurova një asist Lullakut, por nuk shënoi

Kaq ishin mundësitë tona me Spanjën. Luajtëm kundër një ekipi të fortë, me shumë cilësi. Kishim punuar shumë me formacionin e pjesës së parë gjatë gjithë javës, por nuk na shkuan gjërat si duhet. Në pjesën e dytë luajtëm më mirë. Doja që të mund të shënoja në pjesën e parë dhe gjuajta direkt në rastin që pata, por nuk ia dola. Ndërsa në të dytën i dhashë një top fantastik Lullakut, por e pengoi mbrojtësi kundërshtar. Për fat të keq nuk ia dolëm dot, por gjithsesi mendoj se dhamë më të mirën", tha Grezda pas ndeshjes për RTSH.

Firmos deri në fund të karrierës

Andres Iniesta rinovon përjetësisht me Barcelonën



këtunë, - u shpreh 33-vjeçari pas hedhjes së firmës. Lojtari katalanas, produkt i shkollës La Masia, numëron 639 ndeshje me fanellën e Barçës dhe ka fituar plot 30

trofe. Iniesta është i rëndësishëm edhe për Kombëtaren e Spanjës, ku është gjithmonë pjesë e listës së të grumbulluarve nga trajneri Lopetegui.

Rikthimi i strategut

Zyrtare: Jup Hainkes, trajner i Bayern Mynihut




Tashmë është zyrtare, Jup Hainkes është trajneri më i ri i Bajernit të Mynihut. Prej ditësh lakohej rikthimi i bujshëm i 72-vjeçarit, që i zë vendin e Karlo Ançelotit në bankinën bavareze, që u shkarkua pas humbjes ndaj PSG-së. Hainkes do të drejtojë për herë të katërt gjigantët bavarezë, duke firmosur një kontratë deri në qershor të vitit 2018. Ai do të marrë drejtimin e skuadrës më 9 tetor, në ditën ku do të nisë përgatitjet për ndeshjen ndaj Frajburgut, e programuar për 14 tetor. "Nuk do të rikthehesha në asnjë klub tjetër në botë, por Bajerni është

një zgjedhje zemre për mua", ka thënë strategu i Bajernit, me të cilin në vitin 2013, bavarezët arritën të fitonin tripletën e titujve dhe të rikthenin në

Gjermani trofeun e Ligës së Kampionëve. Gjithashtu merr fund dhe çështja e stafit, asistentët e tij do të jenë Peter Herman dhe Herman Gerland.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL


- 1. Janë luftarake me kung fu.
- 6. Eshhtë me helm ajo e agjentëve.
- 12. Skuadra merengue.
- 13. Fillojnë tatëpjetën.
- 14. Ed aktor.
- 15. Një pjesë... orkestrale.
- 16. Një iranian i dikurshëm.
- 18. Janë tek në kanape.
- 19. I bën kush ha bukë.
- 22. Fundi i një fundi.
- 23. Fillojnë aksionin.
- 25. Janë zeshkanë.
- 26. Shumë zëra në këngë.
- 27. Gjysmë turneu.
- 29. Eshhtë grykësi
- 31. Rastisin në krye.
- 32. Sikur ke thënë çdonjerin.
- 34. Janë vite.
- 36. Angot e Lecocq.
- 37. Ende është ndryshe.

- 39. Kush bën... ve në lojë.
- 40. Janë grimca me bërthama.
- 41. Turner këngëtare.
- 42. Të parat në bllok.
- 44. Diftong për leader.
- 45. Dhe Hajria në një balet.
- 47. Neill aktor.
- 49. Ross këngëtare.
- 50. Mund të jetë parabolike.

VERTIKAL

- 1. Janë kundërmuese.
- 2. Vveri pa kufij.
- 3. Kush nuk ka... nuk di të sillet.
- 4. Artikull spanjoll.
- 5. Eshhtë krëmb për grep.
- 6. Mbyllin një krah.
- 7. Edouard piktor.
- 8. Fillojnë profesionin.
- 9. Turke pa kufij.
- 10. Ishte Gjermania e Honecker
- 11. Janë më shumë se dëshira.
- 13. Janë ujërat në llixha.
- 16. Bëhet me kandar.
- 17. I dëgjoji vetëm Odiseu.
- 20. Fillojnë hetimin.
- 21. Një qendër.
- 24. Eshhtë vjedhje.
- 28. Makashi këngëtar.
- 30. Me Alfa në makinë.
- 33. Loriku te Sunderland.
- 34. Një pjesë e momenteve.
- 35. Gjysmë tati.
- 36. Janë legjenda.
- 38. Nget edhe ajo e mirë.
- 40. Myslymi i paharuar i futbollit.
- 42. Ki Moon i OKB.
- 43. Flemig që krijoi James Bond.
- 45. Fillojnë hapur
- 46. Mbyllin komentin.
- 47. Fillojnë sefte.
- 48. Fillojnë masat.

Fjalëkryqi (2)




HORIZONTAL

- 1. Eshhtë kombëtare me minoritetin.
- 6. Janë godinat e banimit.
- 12. Van Nistelrooy bomber.
- 13. Eshhtë e e pas Krishtit.
- 15. Një fjalë para kohe.
- 16. Organizma Tregare Lokale.
- 18. Rripi pa zë.
- 20. Filoko aktor
- 21. Volumi i shkurtër.
- 22. Eshhtë diletant.
- 25. Kufizojnë pozicionin.
- 26. Eshhtë X ajo e sulmit.
- 27. Ishin shoqëruessit e Panit.
- 29. Kufizojnë katete.
- 30. Janë qypa.
- 31. Bartok kompozitor.
- 34. Tri të parat në atletikë.
- 36. Tekat pa kufij.
- 37. Një pemë.
- 38. Skuadër greke.
- 7. Lodh në kufij.
- 8. Ishte lumi i harresës.
- 9. Eshhtë për medaljen e parë.
- 10. Një fjalë që tregon ritmin.
- 11. Kolegji i famshëm anglez.
- 14. Janë pesë të tillë olimpikë.
- 17. Janë zëngjinë.
- 19. Kishte 100 porta.
- 23. Një pjesë e masakrës.
- 24. Mbarojnë fare.
- 28. Janë toka edhe sportive.
- 31. Stoker që shkroi Dracula.
- 32. Eshhtë byrek.
- 33. Hapur pa kufij.
- 35. Pal latinisht.
- 39. Rraçe pa re
- 40. Film i famshëm me Brad Pitt dhe Kevin Spacey.
- 43. Qyteti i përjetshëm.
- 44. Një jepet për hartim.
- 45. Jessica aktore.
- 50. Cruise aktor
- 52. Janë në kupë.


VERTIKAL

- 1. Janë shkaktarë sherri.
- 2. Kanë bërë vepra.
- 3. Eshhtë shtëpi me frëngji.
- 4. Fillimi i ideologjisë.
- 5. Iniciallet e Einstein.
- 6. Janë gazetaz si RD.

Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

	6		1	5		8		
1								3
		2	7		4	1		
9			4	1	3			6
	7					5		
6			5	7	9			4
	4	9		1	3			
2								8
	9	8		6		7		

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

2	1	3	4	8	6	5	7	9
7	9	8	3	1	5	4	2	6
4	5	6	9	7	2	8	3	1
3	6	4	1	5	8	2	9	7
9	7	5	6	2	3	1	4	8
1	8	2	7	9	4	3	6	5
5	2	7	8	4	9	6	1	3
6	4	9	5	3	1	7	8	2
8	3	1	2	6	7	9	5	4

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Mos i besoni shkrimeve të vjetra, mos besoni asgjë vetëm se populli juaj i beson
- ose sepse ju kanë detyruar t'i besoni që nga fëmijëria. Ndaj çdo gjëje vepron me arsye; pasi ta keni analizuar, nëse mendoni se është mirë për të gjithë, atëherë besojeni, jetojeni, dhe ndihmoni fqinjnin tuaj ta përjetojë edhe ai vetë.
- Eshhtë më e rëndësishme të parandalosh që një kafshë të vuajë, sesa të rrisht ulur e të meditosh për të kjoqjat e Universit duke u lutur në shoqërinë e priftërinjve.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

2	14	2	7	4	3	9	7	19	3	6		
4	2	5	3	2	8	9	7	6	8	4	14	
PI	3	RM	6	A			17	1	8	9	6	2
7	10		18	9	7	4	9	5	6	4		7
6		5	4	3	3	2	12	9	4	2		20
	5	2	4	2	1	3	9	4	2	4		6
3	1	5	6	8	4	9	7	2	4		12	8
2	8	2		15	6	4	4	4	7	1	15	
16	9	16		2	14	6	9		1	8	2	
2	4	2	3		1	14	6			12	6	3
4	1		2	6		17	6	4	6	14		
6	3	7	9	18	6	4		15	6	7	2	4

R	O	M	A	N	C	I	E	R	E	T	C		
I	R	O	N	L					T	R	U	P	
T	R	T	A	R	T	A	R	E	T				
K	A	M	E	R	I	E	R	E	T				
D	E	L	I	R	A	N	T	E	T				
C		T	A	B	O	R		A	T	A			
K	R	I	P	E						A	O	L	E
S	L	O		I	L	P				R	A	U	L
T	A	N	T	A	L	I				U	R	R	A
U	S				R	E	K	I	P	I	T	E	
F	A	T	A	L		A	L	I	E	N	E	T	
E	T	A	P	A	T		K	A	T	E	T	I	

PËRGIJQJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALLUAR

A	T	M	L	T	R	A	J	T	A	T		
P	L	K	A	P	A	L	I	E	N	E		
R	E	K	O	R	D	E	T	P	M	T	R	
I	A	N	S	A	M	B	L	I	H	E	M	
M	A	R	T	I	N	E	D	E	N	I	N	E
O	H	A	R	A	T	T	I	T	R	A	T	
B	A	N	A	P	I	S	H	E				
E	P	I	T	E	T	E	T	T	E	S	T	
M	I	N	A	T	A	N	A	I	T	M	A	R
I	K	A	P	A	R	O	J	A	T			
E	T	I	K	A	S	E	N	A	T	O	R	I

FJALËKRYQI (2)

K	A	A	S	L	U	L	I	M	A	T	A		
A	R	R	A	S	B	A	R	N	U	M	R		
L	A	T	A	B	R	O	A	E	F	I			
				E	L	E	M	E	N	T	A	R	E
A	N	E	T	A	R	E	S	I	A	I	N	I	
M	I	N	I	M	A	L	A	L	E	K	O		
I	K	L	I	T	A	R	E	T	E	M	A		
E	S	E	N	I	N	E	R	I	E	R			
P	A	N	A	I	M	E	K	N	I				
E	T	N	I	E	M	T	I	N	E	M	A		
L	O	T	A	S	D	R	I	T	A	I			
A	L	E	I	N	E	M	I	S	A	R	E	T	

Thënie të mëncura

- "Çfarëdo që ju jeni, të jeni i mirë." **Abraham Lincoln**
- "Pengesat janë ato gjëra të shëmtuara, që ju shihni kur i largoni sytë nga qëllimi juaj." **Ford Henry**
- "Imagjinata është fillimi i krijimit. Ju imagjinoni atë që dëshironi dhe më në fund ju e krijoni atë." **George Bernard Shaw**
- Njeriu kur ndjen dhimbje, është i gjallë.. Por kur ndjen dhimbjen e tjetrit, atëherë është NJERI.
- Tre janë metodat nga marrim dije: e para, nga reflektimi që është më fisnikja; e dyta, nga imitimi që është më e thjeshta dhe e treta nga eksperiencia, që është më e hidhura. **(Konfuci)**



Astronaute e së nesërmes

E ardhmja
është emocionuese.

Ready?

 **vodafone**